




RAPORT I VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR (VSM)



RAPORT I VSM PËR HARTËN ZONALE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT

Prizren, Shtator 2019



RAPORT I VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR (VSM)

RAPORT I VSM PËR HARTËN ZONALE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT

Autor:

PRIMA Engineering
Adresa: Aktash D2 Nr.10, Prishtinë
Tel.&Fax.: +383 44 110 638
Mob.: +383 (0) 44 110 638
E-mail: info@prima-ks.com

Vizion Project

Adresa: Mehmet Gradica, Kati 1, Nr. 10, Prishtinë
Tel.&Fax.: +383 (0) 45 222 888
Mob.: +383 (0) 45 222 888
E-mail: info@vizionproject.com

Investitor:

Komuna e PRIZRENIT

Prizren, Shtator 2019



RAPORT I VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR (VSM)

RAPORT I VSM PËR HARTËN ZONALE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT

Kryetar i Komunës së Prizrenit:
Z. MYTAHER HASKUKA

*Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit
Hapësinor, Komuna e Prizrenit:*
Z. FATMIR MEMAJ


*Menaxhere e projektit të hartimit të Hartës Zonale të
Komunës së Prizrenit e caktuar nga Komuna e
Prizrenit:*
Znj. SHPRESA OSMANOLLAJ-KRAPI, arkitekte

Hartues i Raportit të VSM
Prof. Asoc. Dr. ELEZ KRASNIQI

*Menaxher i projektit të Hartimit të Hartës Zonale të
Komunës së Prizrenit, i caktuar nga konsorciumi i
kontraktuar:*
Z. ARIANIT BYTYÇI, arkitekt (NTP. PRIMA
ENGINEERING)

*Zëvendësmenaxher i projektit, i caktuar nga
konsorciumi i kontraktuar:*
Z. SHKËLQIM OSMANI: arkitekt (NNSH. VIZION
PROJECT)

Prizren, Shtator 2019



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Kabineti i Ministritit / Kabinet Ministra / Kabinet of the Ministër

DATE/A:	02.09. 2019
REFERENC-Ë:	19/5481/2-722/DMMU
PËR/ZA/TO:	"Komunës së Prizrenit" Prizren, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapsinor.
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Fatmir Matoshi, Minister i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e ka pranuar Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartat zonale të Komunës së Prizrenit të dërguar nga ana e Juaj sipas kërkesës së protokolluar me nr.: 19/5481/2-722/DMMU, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartat zonale të Komunës së Prizrenit
2. Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Kabineti i Ministrisë / Kabinet Ministra / Kabinet of the Minister

Në bazë të nenit 28.paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, nenit 13 të Ligjit për Vlerësim Strategjik Mjedisor Nr. 03/L-230 , si dhe nenit 42 dhe 44 të LPPA-së (Nr.05/L-031), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nxjerr këtë:

Nr: 46
Dt: 15.10.2019

V E N D I M

APROVOHET kërkesa nga Komunës së Prizrenit" Prizren, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapsinor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartat zonale të Komunës së Prizrenit.

A r s y e t i m

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka shqyrtuar kërkesën, kërkesën, dokumentacionin, Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartat zonale të Komunës së Prizrenit, Proces verbalin i Debatit Publik për draft raportin e VSM-së për Hartat zonale të Komunes së Prizrenit, listen e pjesmarrësve në debat publik të dorëzuar nga Komuna e Prizrenit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapsinor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartat zonale të Komunës së Prizrenit , Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapsinor - Komuna e Prizrenit, vlerëson që:

" Komunës së Prizrenit" Prizren, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapsinor, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor **i jep Pëlqim Mjedisor** për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartat zonale të Komunës së Prizrenit dhe njëherit të respektohen kriteret mjedisore dhe masat për mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit të parapara në Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartat zonale të Komunës së Prizrenit.

Faqe 2 nga 3



Në qoftë se, vie deri te ndryshimi i Hartat zonale të Komunës së Prizrenit, duhet të hartoj Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe të aplikoj në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për Pëlqim Mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartat zonale të Komunës së Prizrenit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të të njejtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 19/5481/2 -722/46/19 datë:02.10.2019

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VSM
3. Inspektoratit të MMPH-së
4. Zyrës të Sekretarit të Përgjithshëm
5. Kabinetit të Ministrit
6. Arkivi i MMPHsë
7. Kuvendit të Kosovës

Fatmir Matoshi

Ministër i MMPH





LISTA E SHKURTESAVE

AKMM - Agjencia Kosovarë për Mbrojtjen e Mjedisit
BE - Bashkimi Evropian
GIS – Sistemi i Informacionit Gjeografik
GNP - Grimcat e Ngurta Pezull
HZK - Harta Zonale Komunale
HZKP- Harta Zonale e Komunws sw Prizrenit
ISN – Indeksi i Sipërfaqes së Ndërtuar
ISHPKZh- Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës Kadastrale për Zhvillim
KFK - Komuna e Prizren
MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MMPH- Ministria e Planifimit Hapësinor
NOQ - Ndotsë Organike të Qëndrueshem
NTPH- Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor
OBSh - Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ - Organizata Jo Qeveritare
OZHM - Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
PRRH – Plani Rregullues i Hollësishëm
PZHK - Plani Zhvillimor Komunal
PZHK- Plani Zhvillimor Komunal
SAP- Sipërfaqja Absorbuese e Parcelës
SGJAP – Sipërfaqja Gjellbëruese e Absorbuese e Parcelës
SGJP – Sipërfaqja Gjellbëruese e Parcelës
TeR - Termat e Referencës
UA- Udhëzimi Administrativ



UNDP - Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara

UNEP - Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara

VBJ – Vendbanime jo Formale

VN- Vija Ndërtimore

VNM - Vlerësim i Ndikimit në Mjedis

VNN- Vija Ndërtimore Ndihmëse

VR- Vija Rregulluese

VSM - Vlerësim Strategjik Mjedisor

ZVM - Zona e Veçanta e Mbrojtura

Lista e figurave

Figura 1. Vendndodhja e Komunës së Prizrenit në Kosovë

Figura 2. Ndarja e Menaxhimit të Mbeturinave në Prizren (sasia e mbeturinave në ditë)

Figura 3. Harta e zonave të mbrojtura

Tabela 1. Popullsia në rajonet e Prizrenit

Tabela 2. Kategoritë kryesore të zonave që paraqiten në kuadër të zones urbane janë

Tabela 3. Tabela e Identifikimit të Ndikimeve Mjedisore për çdo Prioriteti dhe Faktori Mjedisor (√: Ndikimi i Prioritetit në faktorin mjedisor, X: nuk ka efekt të Prioritetit në faktorin mjedisor).

Tabela 4. Tabela e Parashikimeve të Ndikimeve Mjedisore për çdo Prioriteti dhe Faktori Mjedisor, sipas deklaratës se mëparshme

Tabela 5. Përmbledhje e ndikimeve mjedisore të parashikuara negative tek faktorët mjedisorë dhe të masave të propozuara të trajtimit të tyre.

Tabela 6. Plani i monitorimit



PËRMBAJTJE

1. PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE	9
2. HYRJE DHE PROCEDURA PËR VSM	11
2.1. Hyrje dhe procedura VSM	
2.2. Informacion i përgjithshëm për VSM	
2.2.1. Përkufizime për VSM	
2.2.2. Rëndësia e VSM	
2.2.3. Problemet në zbatimin e VSM	
3. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE	19
3.1. Direktiva VSM e BE-së	
3.2. Direktiva të tjera të BE-së	
3.3. Strategjia 2020 e BE-së	
3.4. Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të KB	
3.5. Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokolli i Kievit	
3.6. Konventa ESPOO dhe Protokolli i Kievit	
3.7. Historiku Legjislativ, Organet Administrative Përgjegjëse	
3.8. Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit (VSM)	
4. GJENDJA EKZISTUESE – ANALIZA	23
4.1. Pasqyra e përgjithshme	
4.2. Struktura topografike	
4.3. Malet dhe fushat	
4.4. Rrafshinat	
4.5. Pjerrësia	
4.6. Lumenjtë dhe sipërfaqet tjera ujore	
4.7. Struktura gjeologjike	
4.8. Burimet e ujit	
4.9. Burimet minerale	
4.10. Kushtet klimatike	
4.11. Vlerat natyrore	



4.12.	Erozioni	
4.13.	Trashëgimia natyrore	
4.14.	Transporti dhe infrastruktura	
4.15.	Bujqësi	
4.16.	Ujesjellesi	
4.17.	Kanalizimi	
4.18.	Menaxhimi i mbeturinave	
4.19.	Furnizimi me Energji Elektrike	
4.20.	Trashigimia kulturore	
4.21.	Zonat e Veçanta të Mbrojtura	
4.22.	Profili demografik	
4.23.	Zonat e Veçanta të Mbrojtura	
4.24.	Shërbimet arsimore	
4.25.	Struktura e konomike	
4.26.	Bujqesia	
4.27.	Turizmi	
5.	PËRSHKRIM I PËRGJITSHËM I PLANIT	44
5.1.	Qëllimi dhe objektivat e Planit	
5.2.	Arsyetimi	
5.3.	Lista e Zonave	
6.	PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE	50
6.1.	Objektivat e VSM-së për Hartën Zonale Komunale të Prizrenit	



6.2.	Projekt-Raporti perfundimtar	
6.3.	Roli dhe natyra e Hartës Zonale Komunale	
6.4.	Kriteret mjedisore qe kufizojne Zhvillimin Komunal	
6.5.	Kritere të trashëgimisë kulturore	
6.6.	Kritere të forta mjedisore-shëndetësore	
7.	NJOHJA DHE PARASHIKIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE	56
7.1.	Ndikimet mjedisore	
7.2.	Tajtimi i ndikimeve mjedisore të propozimeve të HZK të Komunës së Prizrenit	
8.	MONITORIMI	79
9.	LITERATURA	82



1. PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

Proçesit të Vlerësimi Strategjik Mjedisor i nënshtrohet hartimi i Hartës Zonale Komunale të komunës së Prizrenit. VSM hartohet në zbatim të detyrim ligjor, i cili parashihet në nenin 23 të Ligjit të Planifikimit Hapësinor nr. 04/L-174. Metodologjia e cila është përdorur në këtë VSM është në përputhje me Direktivën e BE: 2001/42/EC, mbi vlerësimin e efekteve të disa Planeve dhe Programeve në Mjedis dhe ligjin për Vlersimin Stragjik Mjedisorë, i cili është transpozimi i direktivës së BE 2001/42/EC. Vlerësimi Strategjik Mjedisor është një studim mjedisor, i cili vlerëson ndikimet e Hartës Zonale në mjedis dhe në veçanti, në tokë, ajër, ujë, klimë, florë dhe faunë, në mbeturina, mjedisin akustik / zhurmat, në popullsi dhe asete, kulturë (qendrat arkeologjike, monumentet, etj.) dhe në peizazh. Por meqënëse studimi VSM ka karakter strategjik dhe vlerëson Objektivat Strategjike dhe Akset Prioritare të HZ të propozuar, nuk i referohen detajeve apo projekteve të veçanta, të cilat janë vlerësuar për ndikimin e tyre në mjedis në studimet e tjera të Vlerësimeve të Ndikimit në Mjedis.

Për ndikimet mjedisore të identifikuar si negative, Studimi i Vleresimit Strategjik të Ndikimeve Mjedisore propozohen masat për perballimin e tyre, të cilat janë kryesisht parandaluese dhe kanë të bëjnë me masat strategjike dhe jo me masa të hollësishme, pasi ato janë subjekt i Studimeve të Ndikimit në Mjedis. Shënohet se Studimet e Ndikimit në Mjedis që do të përgatiten në të ardhmen për projekte të ndryshme të propozuara të infrastrukturës teknike apo projekte të zhvillimit në zonën e komunës së Prizrenit, duhet të marrin parasysh Vlerësimin Strategjik Mjedisore (VSM), për të qenë më efektiv në identifikimin, parashikimin dhe vlerësimin e ndikimeve mjedisore të projekteve si dhe formulimin e masave për të trajtuar këto ndikime mjedisore. Masat për trajtimin e ndikimeve mjedisore janë përmbledhur më poshtë në Tabelën 1.1:



Konkluzioni i Studimit të Vlerësimit Strategjik në Mjedis është se ndikimet negative janë të kufizuara në faktorë të veçantë të mjedisit (tokës, ujit, biodiversitetit, mbeturinave, mjedisit akustike / zhurmave dhe peizazhit), ndërsa ndikimet pozitive të Projektit për Hartën Zonale të komunës së Prizrenit të propozuar janë të rëndësishme dhe kanë të bëjnë me të gjithë faktorët e mjedisit. Kjo është një e vërtetë që pritet pasi nga fillimi i draftimit të propozimeve të tij, plani ka marrë parasysh kriteret e zhvillimit të qëndrueshëm, duke integruar dimensionin mjedisor dhe parametrin e mbrojtjes dhe përmirësimit të mjedisit natyror, kulturor dhe njerëzor në çdo objektiv strategjik në secilin prioritet. Pra, që nga fillimi, plani kishte orientim miqësor me mjedisin, dhe për këtë arsye nuk është për t'u habitur që në vlerësimin e ndikimeve mjedisore të tij, shumë ndikime pozitive dhe shumë negative shpesh varen nga mënyra e zbatimit të panit dhe jo direkt nga rekomandimet e planit.



2. HYRJE DHE PROCEDURA PËR VSM

2.1. Hyrje dhe procedura e VSM-së

Ky studim VSM përgatitet me qëllim vlerësimin e mjedisit të Hartës Zonale të komunës së Prizrenit. Hartohet në zbatim të ligjit Ligji Nr. 03/L-230 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor", i cili është në përputhje me Direktivën e BE: 2001/42/EC Mbi Vlerësimin e Efekteve të disa Planeve dhe Programeve në Mjedis" ndiqet procedura e mëposhtme:

Së pari realizohet një konsultim paraprak me grupet e interesit, ku paraqiten a) koncepti i Vlerësimit Strategjik të Ndikimit në Mjedis, b) procedurat për aplikimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, c) faktorët e rëndësishëm mjedisorë që pritet të preken nga propozimet e PPV dhe d) realizohet diskutim me qëllim që palët e interesit të shprehin pikëpamjet e tyre mbi ndikimin mjedisor të HZ dhe të regjistrohen shqetësimet e tyre në lidhje me çështjet e mjedisit.

Në vazhdim përgatitet dhe dorëzohet Vlerësimi Strategjik Mjedisor (buletin dhe harta shoqëruese), me strukturën dhe përmbajtjen, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor. Realizohet konsultim në lidhje me gjetjet e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, në lidhje me ndikimin mjedisor të HZ të komunës së Prizrenit, e cila në mënyrë procedurale realizohet paralelisht me konsultimet me publikun. Së fundi, duke marrë parasysh gjetjet dhe rezultatet e dy konsultimeve - të VSM dhe të HZ - hartohet Vlerësimi përfundimtar Strategjik Mjedisor, miratimi i të cilit përbën një parakusht për miratimin përkatës të Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit.

2.2. Informacion i përgjithshëm për VSM

2.2.1. Përkufizime për VSM

Një nga vizionet më moderne për vlerësimin e ndikimit në mjedis është institucioni i Vlerësimit Strategjik Mjedisor, i cili zbatohet përmes hartimit të një studimi mjedisor, në fazën primare të



një plani strategjik zhvillimi, në nivel politik, projekti, programi, domethënë jo të një projekti individual. Ky studim mjedisor quhet Vlerësim Strategjik Mjedisor (VSM) dhe në Evropë gjen zbatim vetëm në plane dhe programe - dhe jo në politika - në përputhje me Direktivën 2001/42 KE. Në literaturën ndërkombëtare referimi i parë për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, sipas Noble (2010), kryhet nga Eood & Djeddour në vitin 1989, të cilët e përmendin si vlerësim mjedisor të politikave, planeve dhe programeve, i cili ka një karakter strategjik në lidhje me atë të projekteve individuale. VSM merr parasysh objektivat e përgjithshme të zhvillimit të një vendi apo rajoni, efektet kumulative të planifikimit strategjik të propozuar, problemet globale mjedisore, duke lidhur planifikimin strategjik me to (p.sh. efekti serë), por edhe gjithë çështjet e tjera të zhvillimit të 21 qëndrueshëm, për të cilat janë zhvilluar strategji evropiane dhe kombëtare dhe janë vendosur objektiva konkrete p.sh. reduktim të ndotësve serë, menaxhim të integruar të burimeve ujore në nivel baseni, menaxhim të qëndrueshëm të mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme, etj. Vlerësimi Strategjik Mjedisor është një proces sistematik dhe gjithëpërfshirës i vlerësimit të ndikimeve mjedisore të një politike, të një plani apo programi, duke përfshirë një raport me rezultatet e konsultimeve me grupet e interesit dhe me konkluzionet e studimit, me qëllim për të ndihmuar në vendimmarrje të një planifikimi strategjik (Therivel dhe Partidario, 1996).

Përkufizime të tjera të rëndësishme që janë dhënë në literaturën ndërkombëtare po paraqiten si më poshtë:

VSM është një vlerësim i parë i skenarëve alternativë dhe i propozimeve që kanë lidhje me planet e propozuara apo tashmë të miratuara, me programe dhe politika, në kuadër të një vizioni më të gjerë strategjik mjedisor dhe të një sërë objektivash që duhen plotësuar. Qëllimi është që ky vlerësim të drejtojë për nga përzgjedhja e alternativave më të mira, me qëllim që në planifikim të arrihet efekti i dëshiruar (Noble, 2000).

VSM përbën një proces kompleks dhe të strukturuar, që ka si qëllim vlerësimin e ndikimit në mjedis të propozimeve strategjike (të politikave, planeve, programeve) dhe propozimin e masave të mundshme për të trajtuar ose ndaluar efektet apo masat të karakterit parandalues për shmangien e shfaqjes së ndikimeve apo nxitjen e ndikimeve/efekteve pozitive të propozimeve strategjike në mjedis. Ky proces përfshin edhe një raport me shkrim me rezultatet e



konsultimeve. Rezultatet e këtij procesi përdoren nga autoritetet kompetente gjatë vendimmarrjes për zbatimin e planifikimit strategjik (Risse et al., 2003).

VSM përbën një proces sistematik për vlerësimin e ndikimeve mjedisore nga politikat, planet dhe programet e propozuara, me qëllim për tu siguruar se merren parasysh, qysh në një fazë të hershme të procedurës së vendimmarrjes, çështjet mjedisore të propozimeve të tyre, në kombinim me parametra ekonomike dhe sociale (Sadler dhe Verheem, 1996). Ky përkufizim thekson se VSM përbën një proces të tërë - merr pjesë paralelisht me procesin e planifikimit strategjik - dhe nënvizon se rezultatet e VSM merren parasysh në vendimet përfundimtare mbi planifikimin strategjik (Glasson et al., 2012.). Theksohet se ky përkufizim është ndër të parët që është dhënë për VSM dhe mbulon plotësisht objektin e tij, dhe referohet në pjesën më të madhe të punimeve dhe artikujve shkencorë që kanë si objekt VSM.

VSM përbën një mjet të rëndësishëm i cili ndihmon që faktorët mjedisorë të përfshihen në marrjen e vendimeve në nivel strategjik dhe për rrjedhim, ofron një përpjekje efikase në arritjen e qëllimit për një zhvillim të qëndrueshëm (Therivel dhe Partidario, 1996). Siguron integrimin e çështjeve mjedisore që nga fillimi i procesit të vendimmarrjes, siguron një kuadër për vazhdimësinë e veprimeve në nivel të propozimeve strategjike, kontribuon në politikën e zgjeruar të planifikimit dhe ka potencial të identifikojë ndikime të mundshme mjedisore që në fazat e hershme, para se të zhvillohen planet strategjike dhe programet (Desmond, 2007).

VSM vlerëson ndikimin e politikave, planeve dhe programeve në nivel strategjik, si rrjedhim, kërkohen metodologji të ndryshme të vlerësimit mjedisor të ndikimeve në lidhje me ato të Studimeve të Ndikimeve Mjedisore të projekteve individuale dhe ka shumë vështirësi, pasi p.sh. nga një plan apo një program mund të gjenerojnë shumë projekte të ndryshme në zbatim të tyre (Dalal-Clayton dhe Sadler, 2003). Gjithashtu, ndarja ndërmjet politikave, planeve dhe programeve është shpeshherë fluide dhe e paqartë, pasi nuk ka kufijë të qarta ndarës ndërmjet tyre dhe në lidhje me propozimet që ato bëjnë. Në qoftë se merret parasysh akoma edhe ekzistenca e një numri të 22 madh projektsh dhe programesh mbi tema të ndryshme p.sh. energjia, transporti, turizmi, akuakultura, industria etj dhe shpesh herë ka mbivendosje në propozimet e tyre, atëherë është e kuptueshme se po zhvillohet një kompleksitet edhe në vlerësimin përkatës të ndikimit të tyre në mjedis përmes VSM (Fischer, 2003). Së fundi, VSM,



në varësi të fushës së tyre të zbatimit, ndahen në VSM të bazuara në politika («Policy-based SEA»), domethënë në thelb në politika qeveritare, VSM sektoriale për planet dhe programet përkatëse p.sh. për turizmin, zhvillimin industrial, menaxhimin e zonave bregdetare apo zonat malore, promovimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, etj, dhe VSM hapësinore që kanë lidhje me nivele të ndryshme të planeve ose programeve hapësinore që kanë referencë në zona të veçanta gjeografike në të cilat zbatohen planet dhe programet në fjalë (Noble, 2010).

2.2.2. Rëndësia e VSM

VSM kërkohet që të mbulojë një "boshllëk" të institucionit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të projekteve dhe aktiviteteve, dmth, VSM kanë mundësinë të mbulojnë disa të meta të Vlerësimeve të Ndikimit në Mjedis. (Therivel dhe Partidario, 1996):

VSM janë të dobishme për shkak se ato kontribuojnë në konfigurimin e një kuadri strategjik – plani os eprogrami - më miqësor për mjedisin, brenda të cilit do të ndërtohen në të ardhmen projekte të ndryshme zhvillimore dhe projektete infrastrukturës (Wood, 2003). Është karakteristike, ndërsa në Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis shqyrtohen ndikimet mjedisore të një veprimi të planifikuar zhvillimi, me qëllim minimizimin e tyre, me VSM ngrihen pyetje me karakter parandalues, në lidhje me cilat alternativë zhvillimi është më e mirë dhe cilat objektiva duhet të plotësohen në të ardhmen (Noble, 2010).

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis nuk marrin parasysh efektet kumulative që rezultojnë nga projekte të tjera dhe aktivitetet në zonën e studimit, të cilat mund të jenë në fazë ndërimit apo funksionimit (Glasson et al., 2012), ndërsa VSM kanë mundësinë të vlerësojnë ndikimet kumulative.

VSM kanë mundësi për të vlerësuar në mënyrë mjedisore propozimet alternative të planeve dhe programeve, në mënyrë që zgjidhet për çdo herë ajo që është më miqësore me mjedisin, ndërsa Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis shpesh herë nuk mund të merren me projekte alternative apo masa alternative për trajtimin e ndikimeve, sepse variantet e skenarëve alternativë kufizohen nga hartimi i projektit në nivel strategjik, i cili është paraprirë në kohë (Glasson et al., 2012).

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis shumë herë është i nevojshëm të hartohet në një periudhë kohore të shkurtër, ose përshkak të kufizimeve financiare, ose që të mos vonohet ndërtimi i projektit të



propozuar. Kjo ndihmon për të reduktuar materialin e mbledhur të informacionit dhe cilësisë së analizës së tij. Përkatësisht e reduktuar dhe e dobët mund të jetë edhe përfshirja e qytetarëve në procesin Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (Glasson et al., 2012). Përkundrazi, VSM për shkak se shqyrtojnë planet dhe programet që kanë natyrë strategjike, paraqesin plotësinë paraqitjen e të dhënave mbi mjedisin ekzistues.

Nga ana tjetër, kur një VSM është hartuar në stadet fillestare të procedurës së vendimmarrjes dhe I cili përshkruan gjithë potencialin e mundshëm të zhvillimit të një rajoni, përmes planifikimit strategjik të tij, atëherë sigurohen zgjidhje alternative, mirren në konsideratë ndikimet kumulative, 23 sigurohet përfshirja e qytetarëve në këto procedura dhe vendimet për projekte të veçuara merren përmes një mjedisi parandalues, i cili është paracaktuar përmes VSM (Therivel, 2004). VSM mund të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin e qëndrueshëm, pasi shtrin parimet dhe teknikat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në një nivel më strategjik. Kjo do të nënkuptonte adaptimin e problematikës së parametrave mjedisorë në proceset e vendimmarrjes në të gjitha nivelet: të politikave, të planeve dhe të programeve (Arce dhe GULLON, 2000). Si rrjedhim, studiohen pasojat mjedisore dhe masat për ti përballuar ato në nivel strategjik, ndërsa ka dhe transparencë më të madhe në procesin e vendimmarrjes dhe një përfshirje më efektive të qytetarëve. Por që një VSM të mund të përshkruhet si "i qëndrueshëm", duhet të mos ketë si qëllim të vetëm minimizimin e ndikimeve të një plani apo programi në mjedis, por të formësojë veprimet dhe objektivat e tyre, në mënyrë të tillë që ato të plotësojnë kriteret e objektivat afatmesme të zhvillimit të qëndrueshëm. Gjithashtu, VSM merr në konsideratë projektet afat-gjatë dhe të një shkalle më të madhe, kështu ai mund të përqëndrohet në rrugë të ndryshme ose alternative që çojnë në arritjen e objektivave specifike mjedisore të planeve ose programeve. Për më tepër, shqyrtimi i zgjidhjeve alternative nga VSM, sipas Noble (2000), përbën kusht kyç për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm, pasi gjatë njohjes së zgjidhjeve alternative, kërkohet përfshirja e elementëve socioekonomike dhe biofizike, por edhe mirëkuptimi i lidhjes së tyre të ndërsjelltë dhe të ndërvarur. Për të përcaktuar se cilat nga zgjidhjet alternative kanë më shumë gjasa për të kontribuar në qëndrueshmërinë, është e nevojshme të përcaktohen kriteret në bazë të të cilave merren vendimet e zbatimit të planifikimit strategjik. Këto kritere janë të lidhura kryesisht me besueshmërinë e procesit të VSM p.sh. në



çështjet e konsultimit, por dhe të materialeve të informimit që përdoren. Përveç kësaj, VSM inkurajon konsultimet në mes të palëve të përfshira dhe institucioneve, dhe forcon pjesëmarrjen publike akoma edhe në konsultimin e vet projektit ose programit të propozuar. Përmes konsultimeve të kryera me palët e interesuara, si pjesë e procesit të VSM, është e mundur të identifikohen çështje, nevoja, shqetësime, vlera dhe ide nga ato grupe dhe pjesë të shoqërisë që mund të preken nga një politikë e veçantë, një plan ose një program (Dalal-Clayton dhe Sadler, 1999). Përveç sa më sipër, von Seht (1999) thekson përfitime edhe më konkrete nga zbatimi i VSM të cilat kanë lidhje me sa më poshtë:

Rrit ndjeshëm promovimin e parimit parandalues në lidhje me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të projekteve dhe aktiviteteve.

Detyron planet dhe programet strategjike për të shqyrtuar akoma edhe më shumë zgjidhje alternative, skenarë dhe propozime.

Rrit shanset për vlerësimin e efekteve kumulative, ndikimeve sinergjike dhe indirekte, në krahasim me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të projekteve.

Lidh ndikimet e pritura me problemet rajonale dhe globale të mjedisit.

Forcon transparencën dhe besueshmërinë e proceseve vendimmarrëse, pasi nxit konsultimet dhe kontribuon në ndërgjegjësimin social.

Ofron më shumë besim tek investitorët e mundshëm dhe të kushtëzuar, kontribuon në hartimin e Studimeve më të mira të Ndikimeve në Mjedis, ndërsa njëkohësisht në disa raste është i mundur edhe reduktimi i kohës së nevojshme për lejen mjedisore të disa projekteve dhe aktiviteteve.

2.2.3. Problemet në zbatimin e VSM

VSM përballlet me një numër çështjesh teknike dhe procedurale, probleme të natyrave të ndryshme. Në lidhje me çështjet teknike, projektet e ardhshme të zhvillimit të një zone, të cilat do të rezultojnë nga zbatimi i një plani ose programi, mund të jenë të shumta dhe për këtë arsye, vlerësimi i ndikimit në mjedis krijon një kompleksitet analitik. Informacioni mbi kushtet mjedisore aktuale dhe sidomos të ardhmen - pasi hetohet evolucioni i mjedisit të zonës së studimit, pa miratimin e planit ose programit të propozuar - është zakonisht i kufizuar, siç edhe informacioni mbi natyrën, shkallën dhe pozicionimin e saktë të projekteve të ardhshme të



propozuara, të cilat do të rezultojnë nga zbatimi i planeve dh. Përveç problemeve teknike, të rëndësishme, dhe në veçanti të vështira, paraqiten aspektet procedurale të proceseve vendimmarrëse. Politikat, planet dhe programet paraqiten përgjithësisht me një mënyrë relativisht abstrakte dhe evoluohen vazhdimisht. Për shkak të kësaj dinamike të tyre, është i domosdoshëm studimi i vazhdueshëm i ndikimeve të tyre në mjedis, gjatë gjithë rrjedhës së proceseve vendimmarrëse, fakt i cili e bën Strategjinë e Studimit të Ndikimeve në Mjedis akoma edhe më të vështirë. Përveç kësaj, nuk ka kufijë të qartë për ndarjen e politikave të ndryshme, planeve dhe programeve, domethënë, nuk mund të ketë ndarje të plotë të objekteve midis tre planeve, një për transport, një për energjinë dhe një për përdorimin e tokës, pasi ekzistojnë marrëdhënie të ndikimit të ndërsjelltë në mes tyre. Gjithashtu, vihet re se efektet e një politike varen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga mënyra me të cilën u dha interpretimi në politikë, me qëllim zbatimin e saj, realizimin e saj. Në fund të fundit vendimi është një politikë procesi, fakt që do të thotë se palët e vendimmarrjes nuk do të marrin parasysh vetëm efektet mjedisore nga zbatimi i një politike, i një plani apo një programi, por do të përlllogarisin dhe vet interesat e tyre, si edhe ndikimet në nivel politike (Glasson et al., 2012). Përveç çështjeve të mësipërme, Noble (2003) argumenton se është veçanërisht e vështirë për tu studiuar efektiviteti i një VSM, pasi ai, në një masë të madhe, varet jo vetëm nga efektet e tij dhe nga mënyra se si ai ndikon vendimmarrjen me mbrojtjen e mjedisit, por edhe nga cilësia e procesit të përgjithshëm, siç përcaktohet nga proceset e pjesëmarrjes dhe konsultimet. Akoma edhe sistemet e ndryshme dhe kuadri institucional i VSM në çdo vend, formësojnë kritere të ndryshme për vlerësimin e efektivitetit të tij, të cilat përcaktohen nga direktivat përkatëse dhe kuadri ligjor (Noble, 2003). Si rrjedhim krahasimi midis VSM të ndryshme të vendeve të ndryshme nuk është menjëherë i mundshëm dhe kjo krijon ngatërresë/komplikim në shkëmbimin e pikëpamjeve dhe përvojave, në mënyrë që të realizohet zhvillimi i tyre shkencor. Le të shënohet në këtë pikë se në rastet kur ka çështje të ndotjes ndërkufitare dhe menaxhimit të burimeve natyrore, krijohet nevoja e zbatimit të një VSM ndërkufitare, me gjithë vështirësitë që ai përfshin (Morrison-Saunders dhe Arteve, 2004). Një pikëpamje e ngjashme shprehet edhe nga Fischer (2002a, 2002b), i cili pas një kërkimi dhe studimi në 25 VSM të përgatitura në Britaninë e Madhe dhe Gjermani për politika, plane dhe 25 programe, arrin në përfundimin se kërkojnë një kërkim dhe studim të



mëtejshëm çështjet e mëposhtme:

1. Referenca në lidhje me çështje socio-ekonomike në VSM e projekte.
2. Aftësia që VSM për plane dhe programe të kërkojnë skenarë alternativë që të kenë lidhje me zhvillimin dhe rritjen e sektorëve të tjerë përveç atij që po studiohet.
3. Mënyra integritit të plotë të VSM në projektin për të cilin po përgatitet.
4. Nevoja e pjesëmarrjes së publikut në VSM për programet - pjesëmarrja publike është zakonisht vetëm në VSM për projekte.



3. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

3.1. Direktiva VSM e BE-së

Direktiva e BE-së 2001/42/EC mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe të programeve të caktuara në mjedis u aprovua më 27.06.2001. Kjo direktivë vlen për një varg të gjerë të planeve dhe të programeve publike (p.sh. mbi shfrytëzimin e tokës, transportin, energjinë, mbeturinat, bujqësinë, etj.). Kjo direktivë nuk ju referohet politikave. Direktiva (Parlament i Evropian, 2001) thotë që planet dhe programet në kuptim të Direktivës VSM duhet të përgatiten dhe të aprovohen nga një autoritet (në nivel kombëtar, rajonal apo lokal) dhe të urdhërohen nga dispozitat legislative, rregulluese ose administrative.

3.2. Direktiva të tjera të BE-së

Ekzistojnë shumë direktiva të tjera të BE-së me të cilat Direktiva VSM ka lidhje të qarta dhe të cilat janë të rëndësishme nëse janë duke ushqyrtuar çështjet mjedisore dhe të. Sipas Marsden (2008) VSM-ja ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën VNM, në veçanti me që vlerësimi i mjedisit për sektorët e shënuar nën këtë të fundit duhet ta vendosë kornizën për projektet e shënuara nën këtë të parën. Po ashtu ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën për Vendbanimet, e cila përmendet qartë në direktivën VSM. Direktiva Kornizë për Ujërat bashkërisht me Direktivën për Vendbanimet përmban kërkesat e veta jo vetëm për paraqitjen e planeve dhe të programeve, por po ashtu edhe të vlerësimit, duke nxitur nevojën për procedura të bashkërenduara ndërmjet ligjeve të ndryshme.

3.3. Strategjia 2020 e BE-së

Përveç dokumenteve të sipërpërmendura legislative të BE-së, strategjia 2020 e BE-së me prioritetet, objektivat dhe nismat më të mëdha është dokument i rëndësishëm i politikave si për



vetë BE-në ashtu edhe për rajonet fqinje, në veçanti Ballkanin Perëndimor me që bashkëpunimi rajonal me këtë rajonë është identifikuar si njëri prej prioriteteve të politikave për BE-në. Në kuadër të strategjisë 2020 të BE-së (Komisioni Evropian, 2010) zgjerimi i mundshëm i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor është identifikuar si mjet i jashtëm i politikave për zhvillim dhe vende pune. Prioritetet e strategjisë janë “zhvillimi i shpejtë, i qëndrueshëm gjithëpërfshirës”. Janë shtatë nisma të mëdha, prej të cilave Evropa efikase sa ju përket burimeve dhe Një politikë industriale për epokën e globalizimit janë drejtpërdrejt të lidhur me çështje të qëndrueshmërisë, por nismat e tjera si Agjenda digjitale për Evropën, Unioni i përtëritjeve, Rinia në lëvizje, Një agjendë përshkathtësi dhe vende të reja pune dhe Platforma evropiane kundër varfërisë dotë mundeshin poashtu të kontribuonin në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm po të zbatoheshin në mënyrë efikase. Në strategji poashtu përfshihen objektivat e matshëm që duhet të arrihen gjatë periudhës së zbatimit, nuk ka dyshim që është plotësisht e dobishme sipër shtetet anëtare aktuale ashtu edhe për ato të ardhshmet që të bashkëpunojnë në mënyrë që t’i arrijnë objektivat mjedisore të strategjisë siç është zvogëlimi prej 20% i emetimeve të gazrave të serrave, 20% rritje të shkallës së energjisë nga gjëra tepër të rritshme dhe nga efikasiteti i energjisë. Prandaj është e arsyeshme që drejtimi i këtyre objektivave të integrohet në strategjitë dhe në planet e veprimit mjedisore kombëtare, rajonale dhe lokale, përfshirë procedurat për vlerësimin strategjik të mjedisit.

3.4. Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit të KB

KB kan një rol aktiv në zhvillimin e Kosovës, edhe pse Kosova nuk është shtet anëtar, KB vepron në Kosovë nën mandatin e misionit UNMIK në mënyrë që t’isigurojë kushtet për jetë të qetë dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës dhe për avancimin e stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor. Objektivat strategjike të KB janë aprovuar në vitin 2000, kur udhëheqësit botërorë u mbledhën në NjuJork për të marrë pjesë në Samitin e Mijëvjeçarit, pjesëmarrësit aprovuan Deklaratën e Mijëvjeçarit të KB (Asambleja e Përgjithshme e KB, 2000) me qëllimin kryesor të përgjithshëm për ta zvogëluar varfërinë me afatin e fundit kohor vitin 2015. Kjo nismë është bërë e njohur si Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit 2. Janë 7 objektiva me qëllime specifike, një prej objektivave i kushtohet qëndrueshmërisë mjedisore, në mënyrë që të sigurohet



vendosja e qëllimeve në vijim: - Integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programete vendit dhe kthim i mbrapsht i humbjes së burimeve mjedisore; - Zvogëlimi i humbjeve të biodiversitetit duke arritur deri më 2010 një zvogëlim domethënës të shkallës së humbjes; - Përgjysmimi i përqindjes së popullsisë pa qasje të qëndrueshme tek uji i sigurt i pijshëm dhe higjiena publike themelore deri në vitin 2 Deri më 2020 të arrihet një përmirësim i rëndësishëm në jetëte sëpaku 100 banorëve të lagjeve të varfra.

3.5. Konventa Århus, Konventa Espoo dhe Protokoli i Kievit

Konventa Århus Kjo Konventë (Konventa për qasje në informata, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për çështjet mjedisore) është aprovuar më 25 qershor 1998 në qytetin danez të Aarhus (Århus) në Konferencën e Katërt Ministrore si pjesë e procesit "Mjedisi për Evropën". Ajo hyri në fuqi më 30 tetor 2001. Konventa Århus vendosë një numër të drejtave të opinionit në lidhje me mjedisin. Sipas konventës (Konventa UNE CE mbi Qasje, 1998).

3.6. Konventa ESPOO dhe Protokoli i Kievit

Konventa Espoo (EIA) (Konventa UNECE mbi Mjedisor, 1991) përcakton obligimet e palëve për ta vlerësuar ndikimin në mjedis të aktiviteteve të caktuara në një fazë të hershme të planifikimit. Poashtu i formulon obligimet e përgjithshme të shteteve për ta njoftuar njëra tjetrën dhe për t'u këshilluar me njëra tjetrën lidhur me të gjitha projekte të mëdha që janë në shqyrtim dhe që ka gjasa të kenën dikim të rëndësishëm të pafavorshëm në mjedis përtej kufijve. Konventa u aprovua më 1991 dhe hyri në fuqi më 10 shtator 1997. Siç thekson Marsden (2008).

3.7. Historiku Legjislativ, Organet Administrative Përgjegjëse

Ligji i Kosovës për Planifikim Hapësinor Ligji për Planifikimin Hapësinor është aprovuar në shtator 2003 dhe është ndryshuar në nëntor 2008 (Ndryshimi i Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligjinr. 03/L-106), ndërkaq në korrik të viti 2013 është aprovuar Ligji i ri i Planifikimit (Ligji Nr. 04/L174) duke pasur si qëllim kryesor:

Rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe urban;



Duhet t'i respektojë parimet e mbrojtjes së burimeve natyrore të dhe ta përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm;

Duhet t'i përkrahë proceset gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse dhe duhet t'i përfshijë të gjitha palët e interesuara dhe komunitetet

Përkrahja e zhvillimeve hapësinore evropiane që janë duke ndodhur etj.

3.8. Ligji i Kosovës për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit (VSM)

Ligji Nr. 03/L-230 nënvizon rëndësinë e integritit të parimeve për mbrojtjen e mjedisit gjatë përgatitjes, aprovimit dhe realizimit të Planeve dhe të Programeve përkatëse nëse është e qartë që këto të fundit kanë ndikime domethënëse në mjedis. Lista e Planeve dhe e Programeve të obligueshme është e përcaktuar në kuadër të ligjit. Ato Plane nuk mund të aprovohen ose t'i dorëzohen organit legjislativ për aprovim pa raportin VSM.



4. GJENDJES EKZISTUESE – ANALIZA

4.1. Pasqyra e përgjithshme

Prizreni është komuna e dytë më e madhe e Kosovës pas Prishtinës. Është një qytet i lashtë historik përgjatë lumit Lumbardhë dhe shtrihet nën Malet e Sharrit. Ai ndanë kufijtë me Shqipërinë në perëndim, me komunën e Dragashit në jug, me IRJ të Maqedonisë në juglindje, me komunën e Shtërpçës në lindje, me komunën e Suharekës në verilindje, me komunën e Rahovecit në veri dhe me komunën e Gjakovës në veriperëndim.




Figura 1. Vendndodhja e Komunës së Prizrenit në Kosovë



4.2. Struktura topografike

Topografia e Komunës së Prizrenit ka strukturë të valëzuar kështu që lartësia ka një shtrirje ndërmjet 300 m - 2600 m. Ndërsa qendra e qytetit është e vendosur në hapësirë të rrafshët, topografia kodrinore vërehet në drejtim të anës perëndimore por në mënyrë më të qartë vërehet kah ana jugore. Vendndodhja gjeografike e Prizrenit ofron kushte të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë, rritjen e kafshëve, industrinë e ushqimit dhe turizëm. Pjesët malore mbi 1500 m mbulojnë përafësisht 15% të të gjithë kufijve komunal. Fusha e Prizrenit është një sipërfaqe e gjerë e rrafshët me një pjerrësi ndërmjet 0-5%. Ajo mbulon rreth 14000 ha që përbën përafësisht 22% të hapësirës së Komunës së Prizrenit.

4.3. Malet dhe fushat

Territori i Prizrenit mbulohet me një pjesë të maleve në vijim: Sharr, Oshlak, Koritinik, Pashtrik dhe pjesërisht përbëhet nga fusha të rrafshëta të luginës së Dukagjinit. Pjesët malore me lartësi mbidetare mbi 1500 m përfshijnë afro 15% të gjithë kufijve komunal. Maja më e lartë në Komunën e Prizrenit ndodhet në Malet e Sharrit në anën lindore dhe juglindore me një lartësi mbidetare prej 2600m (Figura 1.1). Malet e Sharrit kufizohen me Maqedoninë në juglindje, me Komunën e Dragashit në Jug, me Komunën Shtërpçës në lindje dhe me Komunën e Suharekës në verilindje. Lugina e Zhupës, baza e lumit Lumëbardhi, shtrihet përgjatë këtyre maleve drejt Prizrenit. Malet e Pashtrikut në kufirin Shqiptar në perëndim janë malet e dyta me lartësi mbidetare me 1950 m.

4.4. Rrafshinat

Rrafshina e Prizrenit është një sipërfaqe e rrafshët me një pjerrësi 0-5%. Ajo mbulon 14000 ha apo 22% të Komunës së Prizrenit. Rrafshina përfshinë edhe fshatrat vijuese: Atmaxha, Caparci, Krusha e Vogel, Landovica, Lutogllava, Malësia e Re, Mamusha, Medveci, Novaka, Pirana, Randobrava, Sërbica e Eperme, Sërbica e Poshtme, Smaçi, Shpenadia, Trepetnica dhe Velezha si dhe qendrën e Prizrenit.



4.5. Pjerrësia

Pjerrësia e terrenit është vlerësuar me pesë klasa të cilat janë: 0-5%, 5-15%, 15-25%, 25- 40% si dhe mbi 40% (Harta 1.2). Pjesët me pjerrësi prej 0-5% janë basenet e lumit dhe ato formojnë rrafshinën e Prizrenit. Kjo pjerrësi është e volitshme për planifikimin e autostradave të standardit të lartë. Mirëpo duhet marrë parasysh të dhënat tjera gjeologjike. Pjesët me pjerrësi prej 5-15% janë të volitshme për rrugët urbane dhe zhvillimin e aktiviteteve bujqësore me sistem të vaditjes. Kjo pjerrësi vërehet në pjesën veriore të Prizrenit. Pjesët me pjerrësi prej 15-25% janë të volitshme për aktivitete bujqësore por është me rëndësi të futet aktiviteti i ndërgjegjshëm për të evituar erozionin. Në Luginën e Zhupës, shtrihen vargmalet me shpate, ku në disa pjesë të vargmaleve shpatet malore arrijnë pjerrtësinë mbi 40%. Në pjesët perëndimore të Komunës së Prizrenit në Malet e Pashtrikut dhe në jug të fshatit Lubizhda e Hasit, Kabashi i Hasit dhe fshatit Kushnin vërehet pjerrësia mbi 40%. Analiza e orientimit tregon se pjesa më e madhe e zonave në kufijtë komunalë janë në veri, që rezultojnë nga sipërfaqja e thepisur.

4.6. Lumenjtë dhe sipërfaqet tjera ujore

Prizreni është një nga lokacionet fatlume sa i përket resurseve ujore. Lumi më i gjatë dhe më i rëndësishëm në Prizren është Drini i Bardhe (111 km). Ajo hyn në Prizren nga ana veriore dhe vazhdon rrugën e tij kah Shqipëria dhe Deti Adriatik. Lumi formon një liqe të vogël në mes të fshatit Dobrusht dhe fshatit Vërmicë (Harta 1.4). Në terma hidrografie, tërë territori i Komunës së Prizrenit është pjesë e pellgut ujqor të lumit Drini i Bardhë dhe pellgut ujqor të lumit Vardar, përkatësisht Detit Adriatik dhe Detit Egje. Lumi Lumëbardhi e gjatë 35 km, rrjedh përgjatë luginës së Zhupës dhe vazhdon nëpër qendrën e Prizrenit. Një lum tjetër i rëndësishëm është Lumi Toplluha e gjatë 37 km. Ajo hyn në Komunën e Prizrenit nga ana veriore prej Mamushës dhe derdhet në Drinin e Bardhe në fshatin Krajk. Sipas Profilit Komunal të Prizrenit ky lum ka rrezikshmëri më të madhe të vërshimit (2007). Prizreni është i pasur me rezervat e ujërave nëntokësore si dhe ujërave sipërfaqësore që formojnë një potencial të rëndësishëm hidroenergjetik. Hulumtimet hidrogeologjike kryesisht janë bërë në pjesën e dytë të shekullit 20



në lidhje me ndërtimin e hidrocentralit të Zhurit. Këto hulumtime janë ende në vazhdim dhe janë në pritje të finalizimit të projektit dhe fillimin e punimeve.

4.7. Struktura gjeologjike

Morfologjia e terrenit të Prizrenit, bukuritë natyrore, kontrastet e mahnitshme të peizazheve (majat e larta, kodrat e pjerrëta) sipërfaqet e rrafshëta nën kodra etj, kanë tërhequr vëmendjen e shumë hulumtuesve të cilët kanë ardhur këtu si vizitorë apo si turistë. Komuna e Prizrenit është mjaft interesante sa i përket gjeologjisë së saj, aspektit tektonik, petrologjisë dhe pasurisë me minerale. Janë bërë studime, dhe janë publikuar një numër i publikimeve që kanë të bëjnë me gjeologjinë, tektonikën, stratigrafisë, hidrogeologjisë, gjeomorfologjisë, burimeve të mineraleve etj. Aplikimi i teknologjive të reja në hulumtimin e këtyre pasurive është kusht imediat për vlerësimin e këtyre vlerave në funksion të zhvillimit ekonomik. Konstruksioni gjeologjik Prizreni ka shkëmbinj të moshave dhe litologjisë së ndryshme. Shkëmbinj të më të vjetër datojnë nga Paleozoiku, Permiani, Triasiku i hershëm dhe i vonshëm, Jurasik, Kretaku, Neogjeni dhe Kuaternari (Harta 1.5 dhe Harta 1.6). Shkëmbinj të Paleozoikut Shkëmbinj të Paleozoikut formojnë majat e larta të Maleve Kuqibaba, Konjusha e Madhe, Nikolla e Zezë, pjesët e basenit të Lumit të Brodit etj. Këta shkëmbinj janë formuar nga rreshpet kristalin, graniti, migmatitet e granitit etj.

Rreshpet kristaline – albit klorit sericit SAB – ndodhen në mes të Konjushës së Madhe dhe shpateve të Lumëbardhit. Ato formohen nga albiti, sericiti, muskoviti, apatitet etj. Rreshpet klorite sericite Scose – formohen nga shkëmbinj të përbërje të ndryshme. Në disa shkëmbinj, dominon kloriti ndërsa në të tjerat dominon sericiti. Tekstura e këtyre shkëmbinjve është rreshpore me nivele të larta të kuarcit. Rreshpet epidot aktinolit – janë shkëmbinj të metamorfik të formuar pas metamorfozës së shkëmbinjve vullkanike bazalti dhe sfilite. Meta konglomeratet ndodhen kryesisht në verilindje duke filluar nga Brodosana në drejtim të vendit Nikolla e Zezë. Gëlqeret e zeza kristaline – janë gjetur në disa pjesë të Majës së zezë, Konujsh, Kuqibabë etj. Tekstura e këtyre shkëmbinjve është e pllakëzuar me shtresat prej 1.5 m deri 20m. Flitet – janë formuar nga sericiti, kuarci, koloriti, albiti dhe pigmentet organike. Minerale të sekondare janë magnetiti, hepatiti, rutili, zirkoni etj. Ngjyra e këtyre shkëmbinjve zakonisht është e zezë dhe në



raste të radha e përhimët. Metaranoret e kuarçit dhe kuarçiti – gjenden në formë të shtresave të holla dhe ngjyra e tyre është e përhimët. Shkëmbinjtë metagabro – gjenden në veri dhe perëndim të vendit të quajtur Nikolla i Zi. Ato kanë teksturë rreshpore dhe janë të gjelbër. Janë të formuar nga Plaglokliasi, augiti etj. Meta – diabazat – kanë ngjyrë të gjelbër në të përhimët dhe kanë teksturë homogjene. Përbëhen nga plagioklasat, kloriti, epiroti, koesiti etj. Granitet gneis – mund të gjenden në Malet e Sharrit dhe janë të formuar nga kuarçiti, albiti, biotiti, muskoviti etj. Granitet – janë shkëmbinjtë acidike magmatike që gjenden në kurorat e Kuqibabës dhe në Lumbardhë. Granitet janë shkëmbinj metamorfik dhe shumë rrallë kanë reliketet e strukturës preliminare. Shkëmbinjtë Permian – Triasik – gjenden në afërsi të Lubiqevës, Jeshkovë dhe Reqan. Këto shkëmbinj formohen nga sedimentet e pelitit psamit pas një metamorfoze të dobët. Po ashtu përmbajnë konglomerate, kuarçit, shkëmbinjtë magmatike gabro, albit, kuarç – porfirin etj. Shkëmbinjtë e Mezozoikut Shkëmbinjtë e Triasikut – sedimentet karbonike të triasikut të mesëm dhe të vonshëm formojnë masivet e Maleve të Korritnikut, Cvilenit dhe luginën e Lumëbardhit. Shkëmbinjtë e Triasikut përfaqësohen nga gurët masive gëlqerore me shtresa të trasha, mermer dhe dolomit me ngjyrë të përhimët kah e kuqja. Këta shkëmbinj janë të rikristalizuar; struktura e tyre është ksenoblastike dhe janë të formuar kryesisht nga kalciti. Këta shkëmbinj janë të thyer nga lëvizjet tektonike. Shkëmbinjtë e Jurasikut – rrethojnë brezin e përmendur të shkëmbinjve të Triasikut në jug të fshatit Nashec dhe pjesët tjera të regjionit. Përfaqësues i këtyre shkëmbinjve është melanzhi olistromik. Shkëmbinjtë e Kretakut – përfaqësohen nga sedimentet senoniane, të pasuara nga Turoniane dhe më pak nga senomaniane. Senomanian –sedimentet e senomanianit formojnë majat e larta të Pashtrikut. Ato shtrihen në formë transgresive mbi melanzhin e Jurasikut. Shtresat primare formohen nga shtresat e holla të konglomerateve (për këtë arsye nuk duken në hartë) dhe konglomerateve gëlqerore. Fragmentet në konglomerate rrjedhin nga shkëmbinjtë e përzier dhe cementi është kryesisht karbonik. Gëlqerët kryesisht përbëhen nga 60- 80% të CaCo₃ ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga komponenti argjilor i pelitit. Trashësia është 700m. Turonian – sedimentet e Turonianit gjenden në pjerrinat e Pashtrikut dhe janë formuar gradualisht nga gëlqerët e senomanianit. Trashësia e kësaj shtrese është 150 – 200 m Senonian – sedimentet e senonianit gjenden nën pjesët e pjerrëta të Pashtrikut dhe janë formuar gradualisht nga sedimentet e turonianit dhe janë shpërndarë në afërsi të fshatit



Mazrek, Zym dhe Dedaj. Nivelet e larta të senonianit janë kryesisht të përbërë nga peliti dhe gëlqeret me globturkana. Këto sedimente formojnë hipuritet dhe janë të trasha 600m. Shkëmbinj të Kenozoikut Sedimentet e Pliocenit – përfaqësohen nga sedimentet e pliocenit të mesëm dhe të vonshëm që formojnë regjionin e ngushtë të fshatit Gjonaj. Rezervat kryesore të këtyre shkëmbinjve gjenden në pjesën e rrafshët të Prizrenit, në jug të luginës së Dukagjinit. Ato janë kryesisht të mbuluar me sedimentet e kuaternarit. Në afërsi të Krushës së madhe, Landovicës dhe Randobravës, këta shkëmbinj janë kryesisht të mbuluar dhe formohen nga rëra, argjila dhe zhavorri. Në bazë të studimeve, del se shtresat e thella të pliocenit dominohen nga argjila psamite dhe pelite deri në fund të kretakut të vonshëm ku janë gjetur shtresa të qymyrit. Sedimentet e Pliocenit në Prizren kanë ruajtur zgjatimin e tyre parësor, respektivisht kanë shtrirje horizontale dhe një trashësi prej afro 350 m. Në fshatin Gjonaj janë gjetur dy horizonte të qymyrit. Sedimentet e kuaternarit – përfaqësohen nga sedimentet e liqeve dhe të teracave të lumenjve të Pleistocenit si dhe nga depozitat proluviale të terra rosa dhe aluvialet e Holocenit. Sedimentet e liqeve – gjenden në jug të fshatit Nashec dhe luginën e Prizrenit. Janë të përfaqësuara nga argjilat rërore me ngjyrë të verdhë, rëra dhe zhavorri. Trashësia ndryshon prej 20 deri 50 m. Sedimentet e teracave të lumenjve janë kryesisht përgjatë shtratit të lumit Drini i Bardhë dhe janë të trashë 20 m. Depozitimet Proluviale – janë prezent në formë të zonave të vogla të parregullta dhe të izoluar sikur në rastin e fshatit Gjonaj. Janë të përfaqësuar nga pjesët e rumbullakëta dhe gjysmë të rumbullakëta të shkëmbinjve të ndryshëm. Terra Rosa është e zhvilluar në shkëmbinj të Kretakut në gropat e vogla të luginave karstike siç është rasti me fshatin Zym. Trashësia e tyre është 100 m. Sedimentet aluviale – janë kryesisht të koncentruar në shtratin e Drinit të Bardhë dhe përfaqësohen nga materialet argjilore, rëra dhe zhavorri. Tektonika Sa i përket tektonikës së Prizrenit dhe regjionit, ekzistojnë disa mendime dhe hipoteza për shkak të mungesës së të dhënave stratigrafike si dhe komplikimeve me njësitë gjeotektonike. Kjo ka rezultuar me diskutimet e hapura dhe mos kompletimin e të dhënave tektonike të regjionit. Në nivel regjional, pjesa më e madhe e territorit është e ndërtuar nga formacionet eugeosinklinale që i përkasin njësitë gjeotektonike të Korabit dhe Prizrenit. Struktura më imponante është ajo e Pashtrikut e përbërë nga shkëmbinj të Kretakut të vendosura mbi shkëmbinj të Jurasikut që formojnë bazën e saj. Sinklinali i Pashtrikut zgjatet nga juglindja deri



në veri lindje. Krahët e sinklinalit dallohen për nga pjerrësia e butë e shtresave (20-300) dhe strukturat e rrudhosura të nivelit të dytë në krahët e strukturës kryesore. Ky sinklinal ka shumë struktura të shkëputura në gati të gjitha drejtimet (gati 2km).

4.8. Burimet e ujit

Prizreni është njëri prej vendeve fatlume sa i përket sasisë së burimeve të ujit. Lumi më i rëndësishëm dhe më i gjatë në Prizren është Drini i Bardhë (111 km). Ai hyn në Prizren nga veriu dhe vazhdon drejt jugperëndimit në Shqipëri në Detin Adriatik. Lumi formon një liqe të vogël brenda kufijve të fshatit Dobrushë. Lumi i quajtur Lumbardhë me gjatësi prej 35 km rrjedhë nëpër Luginën e Zhupës dhe vazhdon përmes qendrës së qytetit të Prizrenit. Një lum tjetër i rëndësishëm në Prizren është Lumi Toplluha i cili është 37 km i gjatë. Hedhja e mbeturinave organike dhe e ujërave të kanalizimit drejt në lumenj shkakton ndotje të ujit në Komunën e Prizrenit. Sipas Planit Hapësinor të Kosovës, Lumi Drini i Bardhë në Komunën e Prizrenit është i treti me prioritet të tretë brenda vendit për zvogëlimin e ndotjes së ujit. Për shkak të faktit që nuk mblidhen të dhënat e rregullta për cilësinë e ujit dhe nuk ka pasur në dispozicion të dhëna cilësore publike nuk dihet gjendja e saktë mjedisore e burimeve të ujit dhe ndikimi i ndotjes.

4.9. Burimet minerale

Ndërtimi gjeologjik dhe tektonik i Komunës së Prizrenit është treguesi kryesor i pritjeve për paraqitjen e burimeve të mineraleve. Ky territor njihet se ka qenë burim i mineraleve të dobishme në të kaluarën.

Ekzistojnë burime të mineraleve metalike siç është kromi, hekuri, bakri dhe piriti. Mineralet jo-metalike janë të dukshme në të gjitha formimet gjeologjike në krahasim me mineralet metalike. Mermeri i Zhurit, Gjonajve dhe zonave afër kufirit me Maqedoninë janë të lidhura me formimet Paleozoike. Sedimentet e Mesozoikut (Triasiku i vonë dhe i mesëm) kanë veçori të mira dhe tipare teknike të përshtatshme për prodhimin e betonit dhe të gurëve për ndërtim në përgjithësi. Sedimentet e katërsorit janë lymoret dhe brezaret e lumenjve, materialet e thyera, etj. Rëra dhe zhavorri gjenden në Piranë (2.000.000 m³) dhe në Krushë të Madhe (2.000.000 m³). Argjila



gjendet në Landovicë (2.598.072 m³). Burimet e mineraleve jo-metalike siç është rëra; zhavorri, argjila, etj. kryesisht gjenden në kodra. Mineralet e tjera siç janë gëlqerja, shisti i kristalizuar, gurët për ndërtim dhe shisti talk gjenden në pjesët malore. Kjo zonë gjendet në një rajon të pazhvilluar dhe qasja në të është e vështirë.

4.10. Kushtet klimatike

Klima e Prizrenit ka karakter kontinental me një ndikim të butë të klimës mesdhetare në lartësitë më të ulëta, ndërsa klima e ashpër alpine mbizotëron në male. Karakteristikat e buta klimatike krijojnë favor të mirë për burimet e pasura natyrore. Ajo ndihmon në kultivimin e rrushit, si edhe të pemëve dhe të perimeve tjera. Largësia nga deti është një tregues i rëndësishëm i kushteve klimatike dhe Prizreni është 105 km larg nga deti. Temperatura mesatare më e lartë në vjeshtë është 17.6°C. Në 60% të vitit temperatura është më e lartë se 0°C që do të thotë se gjatë 229 ditëve nuk ka ngrica. Sa ju përket të reshurave, mesatarja vjetore është 686 mm në Prizren, duke krijuar kështu kushte ideale për vreshtari sa i përket sasisë së reshjeve. Në Prizren, sasia e reshjeve është me lartë në dimër dhe prandaj shpërndarja e reshjeve të shiut është po ashtu e përshtatshme për vreshtari.

4.11. Vlerat natyrore

Në Prizren, ekzistojnë tri rezerva natyrore si, Maja e Arnetit, Oshlaku dhe Pisha e Madhe të cilat janë të rëndësishme me rezervat e tyre të bimëve të species endemike-relikte Pisha e Bosnjës (*Pinus Heldreicheii*). Sipërfaqja më e madhe e hapësirave të mbrojtura është Parku Kombëtar Sharri që gjendet në Komunën e Prizrenit. Malet e Sharrit gjenden në rajonin e Kosovës dhe të Maqedonisë dhe përfshijnë 1600 km². Pjesa veriore e Maleve të Sharrit i takon territorit të Kosovës dhe përfshin një hapësirës prej 1100 km². Më 1986 Kuvendi i Kosovës ja dha Malit të Sharrit statusin e vendit të trashëgimisë së regjistruar natyrore në klasifikimin e Parkut Natyror. I përkufizuar nga rregulloret juridike dhe plotësimi i kushteve, i përkufizuar nga rregullat dhe marrëveshjet ndërkombëtare, Parku Kombëtar Sharri kishte një plan zhvillimor hapësinor i cili është përgatitur nga Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor.



4.12. Mënyra e shfrytëzimit të tokës

Hapësira e plotë e Komunës së Prizrenit është 63,780.67 ha e cila e bën atë komunën më të madhe të Kosovës. Ajo mbulon përafërsisht 5.94% të krejt territorit të Kosovës (Profili Komunal i Prizrenit, 2007). Mënyra e shfrytëzimit të tokës tregon që mbizotëron karakteri rural. Hapësirat e banueshme janë 3,392.72 ha duke përbërë vetëm 5.3% të krejt hapësirës komunale. Hapësirat bujqësore dhe pyjet mbulojnë 90.05% të kufijve komunalë me një hapësirë të plotë prej 57,434.1 ha. Pyjet në Prizren mbulojnë përafërsisht 8,500 ha përfshirë hapësirat pyjore me intensitet të lartë dhe të ulët të cilat janë vetëm 13% e kufijve komunal.

4.13. Erozioni

Parandalimi i erozionit është një detyrë e cila del nga Plani Hapësinor i Kosovës me qëllim të parandalimit të veprimeve erozive. Në këtë aspekt masat konkrete që duhet të ndërmerren janë:

Parandalimi i degradimit të pyjeve

Parandalimi i mbi kullotjes

Parandalimi i masave materiale që shkaktojnë erozionin

Profili Komunal i Prizrenit (2007) thekson se zonat e mëposhtme janë shpallur si zona erozive:

1. Seria e përroskave të Cvilenit
2. Seria e përroskave të Oshlakut;
3. Përroi Jaglenica, Lumi Lubizhda dhe Lumi Korishë.
4. Përroskat e lumenjve të Landovicës.

Një pjesë e madhe e tokës së Komunës së Prizrenit është në rrezik të erozionit. Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, 23 % e Komunës së Prizrenit i takojnë zonën me rrezikshmëri të lartë për erozion (Tabela 1.6). Sidomos regjioni i Hasit, Kabashit, Lumës, Vërinut dhe Zhupës kanë vlera të larta të erozionit (Harta 1.10). Regjioni i Prizrenit dhe Anadrinisë nuk janë në rrezik të erozionit sepse ndodhen në rrafshinë dhe kanë kushte ideale për aktivitete bujqësore. Kur analizohet modeli i përdorimit të tokës, shihet se qendra e qytetit që ka një densitet më të lartë të popullatës, shtrihet në dy zona erozive që kanë rrezik të ultë dhe mesatar. Erozioni ritet në strukturat topografike me pjerrësi të theksuar, prandaj vendbanimet në zonat malore janë në rrezik të erozionit dhe masat e nevojshme duhet të ndërmerren.



4.14. Trashëgimia natyrore

Trashëgimia natyrore ka një rëndësi të madhe ekonomike, me mundësi të zhvillimit të turizmit që është një faktor kyç për zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajonit. Ruajtja e trashëgimisë kombëtare në shtetet evropiane ka ndodhur që nga shekulli i 19-të, ndërsa në Kosovë, termi i trashëgimisë ka fituar rëndësi vetëm pas Luftës së Dytë botërore. Figura 1.3 tregon zonat, monumentet dhe vlerat tjera natyrore në Kosovë që janë nën mbrojtje. Humbja e trashëgimisë natyrore është çështje e rëndësisë jetike për të gjithë. Shkaktarët janë të ndryshëm si: ndërtimet kaotike në afërsi të zonave me trashëgimi natyrore, prerjet e pakontrolluara të pyjeve, erozioni, shkatërrimi i monumenteve të natyrës me vlera, ndotja e zonave kryesisht turistike, e të gjitha këto si pasojë e mos efikasitetit të organeve menaxhuese për mbrojtje të trashëgimisë natyrore në pajtim me kriteret ndërkombëtare dhe vendore, si dhe vetëdija e ulët e popullatës për ruajtjen e zonave të mbrojtura si potencial i zhvillimit të turizmit dhe ekonomisë së vendit. (Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+).

4.15. Transporti dhe infrastruktura

Kosova nuk shtrihet në asnjë nga rrjetet Trans Evropiane (TEN) por kryqzohet me dy rrugë në Observatorin e Europës Juglindore të Transportit (SEETO) si rrugë kryesore e rrjetit. Këto dy rrugë SEETO janë korridori (rruga) 6 që është kalimi Ribarevina (Mali i Zi) – Ribarice (Sërbi) – Prishtinë (Kosovë) – Shkup (Maqedoni) dhe rruga 7 kalimi Lezhë (Shqipëri) - Prishtinë (Kosovë) – Doljevac (Sërbi) (Ndërtimi i rrugës 7, është parë si prioritet I menjëhershëm me rëndësi kombëtare, ku punimet e kësaj rruge të seksionit jugor në mes të Morinës dhe Prizrenit kanë përfunduar në tërësi përgjatë tërë territorit të komunës së Prizrenit nëpër të cilën kalon traseja rrugore e autostradës ku edhe është i hapur për shfrytëzim, dhe lidhet me autostradën e re posa të ndërtuar midis Milotit dhe Morinës në Shqipëri (Dokument Teknik, Sektori i Transportit).

4.16. Ujësjetësi

Sipërfaqja totale e mbuluar me ujësjetësi është 13.5 km² dhe konsumi mesatar i ujit për banor për ditë është 150 L (Profili Komunal i Prizrenit, 2007). Pjesa më e madhe e rrjetit është e vjetër



më shumë se 40 vjet dhe punimet ende vazhdojnë në përmirësimin e sistemit të ujësjellësit dhe atij të kanalizimit. Edhe pse resurset e ujit në komunë janë të pasura sidomos pas shkrirjes së borës në pranverë, niveli i ujit bie në verë dhe vjeshtë. 60% e komunës gjendet në pjesët e ulëta ky furnizimi me ujë bëhet me gravitacion. 40 % e komunës furnizohet nëpërmjet pompave që paraqesin problem në veti për shkak të reduktimit të rrymës. Ndërmarrja komunale Cvileni menaxhon ujësjellësin dhe kanalizimin në pjesën më të madhe të komunës. Kontrolli i cilësisë së ujit bëhet çdo ditë nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë. Me instalimin e stacioneve për klorizim afër bunarëve, cilësia e ujit është përmirësuar viteve të kaluara. Sipas të dhënave në terren, shumica e fshatrave kanë resurse të mjaftueshme ujore por ka nevojë për një rrjet adekuat të rrjetit të ujësjellësit. Regjioni Podrimës dhe i Prizrenit janë në pozitë më të favorshme sa i përket ujit të pijshëm. Prizreni dhe fshatrat në rrethinë furnizohen me ujë nga katër burime të ujit të pijshëm dhe nga Lumi Lumëbardhi pas filtrimit të duhur. Gravitacioni është duke u përdorur në mënyrë efikase për furnizim me ujë. Në disa fshatra të Hasit përdoret uji nga sistemi i Radoniqit i cili është shumë i vjetër dhe ka nevojë për rehabilitim. Në Landovicë, ka një gravitacion të fortë që mundëson furnizimin me ujë të freskët në nivelin e tokës. Burrimet tjera të rrëndësishëm me kapacitet të lartë të ujit ndodhen në fshatin Poslisht (burrimi Gura) dhe burrimi i ujit në afërsi të fshatit Vërmic, të cilat burime mund të shfrytëzohen për furnizim me ujë të pishëm. Megjithatë, burimet e ujit në Landovicë janë në rrezik të ndotjes nga ujërat e zeza që dalin nga deponia e re regjionale që ndodhet brenda kufijve të këtij fshati. Rajoni i Lumës është me më pak ujë. Vërrini përdor një sistem të vjetër 30 vjeçar. Gypat janë të azbestit dhe sipas kryetarit të Hoçës së Vogël janë paraqitur edhe sëmundje epidemike nga këto gypa.

4.17. Kanalizimi

Sipas profilit komunal të Prizrenit, rrjeti i kanalizimit përfshin 136,493 km dhe mbulon pjesën më të madhe të Komunës. Pas luftës janë zbatuar shumë projekte për rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit por derdhja bëhet drejtpërdrejt në lumenj dhe në disa raste në fusha të hapura pa trajtim paraprak. Duke u bazuar nga të dhënat e marra nga hulumtimet në terren dhe intervistave me kryetarët e fshatrave, Krusha e Vogël dhe Atmaxha kanë kanalizim adekuat dhe janë të



lidhura me rrjetin kryesor të kanalizimit. Mamusha, Zojzi dhe Zhuri kanë sistem të precipitimit para shkarkimit të ujërave të zeza.

4.18. Menaxhimi i mbeturinave

Sipas PZHKP 2025 një kompani publike dhe gjashtë kompani private i menaxhojnë shërbimet për mbledhjen e mbeturinave. Menaxhimi i mbledhjes së mbeturinave nuk ka arritur kapacitet të kënaqshëm ende dhe nuk ka kapacitet për mbulimin e fshatrave përreth, prandaj shkaktohet ndotja e lumenjve. Deponia e vjetër për hedhjen e mbeturinave në fshatin Korishë është mbyllur më 2005 dhe vendi i ri për hedhjen e mbeturinave, i cili i mbulon nevojat rajonale, është në Landovicë. Brendësia e vendit për hedhjen e mbeturinave përfshin komunën e Suharekës, të Gjakovës, të Rahovecit si edhe komunën e Prizrenit. Ajo është projektuar për 500,000 banorë dhe ka kapacitet prej 2,500,000m³. Koha e planifikuar e shfrytëzimit të deponisë është 18-20 vjet. Në kohën e përgatitjes së këtij raporti VSM, Departamenti i Shërbimeve Publike i Komunës së Prizrenit dhe Ekipi i Ekspertëve i JICA ishin duke e përgatitur Planin për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta për Prizrenin, sipas projektit të planit shkalla*2 e mbledhjes së mbeturinave është 70.6% në tërë hapësirën, 78.9% në hapësirën urbane dhe 52.6% në hapësirën rurale. Në Prizren praktikisht nuk bëhet ndarja e mbeturinave në burim. 15.1% e mbeturinave të gjeneruara hedhen në mënyrë të paligjshme dhe 11.8% të tyre largohen nga Ekoregjioni (kompani vendase për menaxhimin e mbeturinave.) Shkalla aktuale e riciklimit është vetëm 5%. Duhet të përmendet që pjesa më e madhe e aktiviteteve të menaxhimit të mbeturinave të ngurta (menaxhimi i deponisë, zgjedhja e deponimë së re) menaxhohen në aspektin nacional, çdo zhvillim tjetër në lidhje me riorganizimet e mëdha në këtë fushë nuk do të mund të vendosej në nivel komunal.




Figura 2. Ndarja e Menaxhimit të Mbeturinave në Prizren (sasia e mbeturinave në ditë)

4.19. Furnizimi me Energji Elektrike

Sipas Profilit Komunal të Prizrenit, 2007, rrjeti elektrik gati se ishte në kolaps për shkak të mungesës së investimeve kapitale sidomos gjatë viteve të 90'ta. Në raport theksohet ekzistimi i fytit të ngushtë si një nga problemet kyçe të furnizimit me energji elektrike. Strategjia e Kosovës për Energji (2005) prezanton një parashikim të kërkesave për energji elektrike për periudhën 2005-2020 (Tabela 1.13) e cila është përpiluar në bazë të dy skenarëve alternative: skenarin e rritjes mesatare dhe atë të rritjes së lartë. Në Prizren, elektriciteti shpërndahet nëpërmes 3 transformatorëve 110Kv si dhe 12 transformatorëve me nga 35Kv (Profili Komunal i Prizrenit, 2007). Për momentin, rrjeti elektrik nuk është eficient.

Strategjia e Kosovës për Energji (2005) parasheh ndërtimin e unazës 400 kV rreth katër nënstacioneve kryesore në Prishtinë, Pejë, Prizren dhe Ferizaj. Raporti po ashtu thekson rëndësinë e gjenerimit dhe shpërndarjes së rrymës elektrike si dhe nevojën për ndërtimin e Hidrocentralit të Zhurit.

4.20. Trashëgimia kulturore

Territori i Kosovës ka një rezervë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore të shumë shekujve dhe Prizreni me siguri është qyteti më i pasur sa i përket trashëgimisë kulturore. Prizreni ka qenë gjithnjë udhëkryq i kulturave dhe grupeve të ndryshme etnike. Gjatë tërë historisë, Shqiptarët,



Boshnjakët, Turqit, Serbët, Goranët, Romët, Ashkalitë dhe Egjiptianët kanë jetuar bashkë në Prizren. Këto civilizime kanë lënë mbrapa një numër të konsiderueshëm të monumenteve sidomos nga koha e perandorisë Osmane, kur Prizreni është bërë qytet i rëndësishëm tregtar për shkak të pozicionit të tij strategjik. Kosova ka një trashëgimi të begatshme arkitektonike dhe arkeologjike, që datojnë nga periudha Neolitike, koha Parahistorike, lashtësia Romake Mesjeta e hershme dhe e vonshme. Si në pjesën tjetër të Kosovës, ashtu edhe në Prizren trashëgimia kulturore mund të klasifikohet në tre grupe: Bizantine/Ortodokse, Monumente Islamike dhe arkitektura vendore (lokacionet tradicionale, tregjet dhe qendrat urbane historike) (Europa Nostra Forum 2006). Islami ka pasur ndikim të madh në zhvillimin e kulturës Shqiptare sa që krijimtaria e saj letrare shprehej në gjuhën Turke, Arabe dhe Persishte në shekujt e parë të sundimit Osman. (Bieber, 2000). Në qendër të qytetit, në bregun e lumit Lumëbardhi, është organizuar Lidhja e Prizrenit si kuvend i përfaqësuesve të Shqiptarëve nga regjionet e banuara me Shqiptar. Sot kompleksi është Muze.

4.21. Zonat e Veçanta të Mbrojtura

Zonat e Veçanta të Mbrojtura janë kategoritë hapësinore të cilat janë përshkruar në detaje në Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (Nr.03/L-039/2008). Ligji në fjalë është pjesë e pakos së Ahtisaarit miratuar nga Kuvendi i Kosovës në Qershor të vitit 2008. Sipas ligjit, në territorin e Kosovës janë identifikuar 45 zona (lokacione) të veçanta të tilla kryesisht i përkasin trashëgimisë kulturore Ortodokse. Këto zona të veçanta janë të ndarë në tre grupe të cilat i kanë karakteristikat e ndryshme. Grupi i parë përmban kufijtë e zonave të veçanta të cilat janë dhënë në harta, grupi i dytë ka një zonë tamponi prej 100m nga perimetri i “oborrit” të zonave të veçanta. Grupi i tretë ka një zonë tamponi prej 50m nga perimetri i “oborrit” të zonave të veçanta. Këto zona të veçanta kanë kritere të caktuara të cilat janë aktivitete primare të ndaluara brenda territorit të këtyre zonave, duke përfshirë ndërtimin e objekteve industriale, digave, termocentrale, furrat, fabrikat, ndërtimin e rrugëve të ndryshme dhe rrugëve tranzite në zonat rurale që përbëjnë shpyllëzimin apo ndotjen e mjedisit të këtyre zonave; dhe së dyti aktivitete të kufizuara që kanë të bëjnë me ndërtimin eventual të objekteve me etazhitet të lartë se monumenti e cila është nën mbrojtje, ndërtimi i rrugëve, punëtori të ndryshme, restorante, hotele, klube nate, pompa të



karburanteve, punëtori të riparimit të automjeteve, vetë-shërbimet, takimet publike dhe urbanizimi i tokës bujqësore. Figura 1.16: Zona të Veçanta të Mbrojtura në Kosovë Në zonat kufitare administrative të Komunës së Prizrenit, gjinden këto zona të veçanta të mbrojtura të cilat i takojnë grupit të parë dhe janë të përcaktuara në harta dhe ato janë: Manastiri i Arkangjelit të Shenjët, Kisha e Shën Gjergjit, Gornjasellë dhe Vetmia e Petrit të Shenjët, Korishë. Zona të veçanta të mbrojtura të cilat i takojnë grupit të dytë, ku këto zona kanë një zonë tamponi prej 100m nga perimetri i “oborrit” të tyre dhe ato zona janë: Manastiri i Markut të Shenjët, Korishë dhe Kisha e Virgjëreshës së Shenjët në Sredskë. Zona të veçanta të mbrojtura të cilat i takojnë grupit të tretë, ku këto zona kanë një zonë tamponi prej 50m nga perimetri i “oborrit” të tyre dhe ato zona janë: Kisha e Shën Nikollës së Shenjët në fshatin Mushnikovë, Kisha e Shën Nikollës së Shenjët në fshatin Bogoshevcë, Kisha e Shën Nikollës së Shenjët në fshatin Drajçiq, Kisha e Shën Nikollës së Shenjët në fshatin Sredskë, Kisha e Apostujve të Shenjët (ose premtimi i Selisë së Shenjët) në fshatin Mushnikovë dhe Kisha e Shën Gjergjit në fshatin Sredskë.




Fig.3. Harta e zonave të mbrojtura



4.22. Profili demografik

Që nga regjistrimi i fundit i vitit 1991, nuk ka të dhëna për popullatën e Kosovës. Numri i vlerësuar i banorëve në Kosovë në fund të vitit 2006 ishte 2,100.000 (Enti Statistikor i Kosovës 2008). Densiteti i popullatës është rritur nga 67 banorë për km² në vitin 1948, në 192 banorë për km² në vitin 2006. Edhe pse gati të gjithë indikatorët e rritjes së popullatës kanë shënuar rënie në dekadën e fundit, popullsia e Kosovës mbetet një nga popullsitë me rritje më të madhe jo vetëm në regjion por edhe më gjerë. Shkalla e rritjes natyrore të popullatës është përafërsisht 13‰ në vit (Profili i Kosovës, 2004).

Tabela 1. Popullsia në rajonet e Prizrenit

Center/Region	2001*		2009**	
	Population	%	Population	%
PRIZREN	138,042	62.53	~150,000****	61.26
Prizren	7,190	3.26	7,880	3.28
Has	20,844	9.44	20,825	8.68
Kabash	7,000	3.17	10,412	4.34
Luma	12,140	5.50	14,210	5.92
Podrimi	14,019	6.35	18,600	7.75
Vrini	10,419	4.72	9,080	3.78
Zhupa	11,122	5.04	11,980	4.99
Total	220,776	100.00	~240,000***	100.00

4.23. Shërbimet arsimore

Duke pasur parasysh faktin se gjysma e popullatës së Kosovës është nën moshën 25 vjeçare, arritja arsimore është një aspekt i rëndësishëm i zhvillimit njerëzor. Mungesa e të dhënave të azhurnuara zyrtare (duke përfshirë grupmoshat) e vështirëson matjen e efikasitetit të shërbimeve arsimore. Sipas të dhënave të Drejtorisë Komunale të Arsimit të vitit 2009, në komunën e Prizrenit ka 12 shkolla të mesme ku 6 nga to gjenden në vendet rurale. Edhe Mamusha ka shkollën e vet të mesme por ajo nuk është e regjistruar në listën e Drejtorisë Komunale për Arsim sepse Mamusha është shndërruar në Komunë. Sa i përket regjioneve rurale, përqendrimi i shkollave në pjesën veriore të komunës tregon se sidomos fshatrat juglindore nuk kanë qasje të duhur ndaj shkollave të mesme. Përveç kësaj, objektet parashkollore gjenden kryesisht në pjesën rurale veriore të Prizrenit dhe ato nuk mjaftojnë për nivelin e komunës. Vlerësimi i përgjithshëm



i numrit të objekteve arsimore dhe numrit të nxënësve tregojnë se Hasi dhe Anadrini janë regjione më të avancuara në krahasim me regjionet tjera në aspektin e numrit të objekteve shkollore dhe numrit të nxënësve.

4.24. Struktura ekonomike

Ky seksion ka për qëllim të prezantojë situatën ekzistuese ekonomike në Komunën e Prizrenit. Analiza ekonomike është pjesë integrale e përgatitjes për PZHKP 2025 dhe çështjet kryesore të shqyrtuara janë bujqësia, industria, tregtia dhe turizmi me ç'rast janë përshkruar në aspektin hapësinor me fakte dhe trendët që përfaqësojnë aktivitetet ekonomike në Kosovë. Titujt e analizës së strukturës ekonomike janë marrë nga Klasifikimi ndërkombëtar i aktiviteteve ekonomike të departamentit për çështje sociale dhe ekonomike të Kombeve të Bashkuara të vitit 2008. Treguesit e strukturës ekonomike në këtë raport janë: bujqësia, prodhimtaria, ndërtimtaria, tregtia, turizmi dhe aktivitetet financiare.

Secili komponent është analizuar në dy faza: në aspektin e Kosovës në përgjithësi dhe si komunë në veçanti dhe së dyti në aspektin e vizitave në teren të kryera në Mars dhe Prill 2009. Sipas profilit të Kosovës të vitit 2006, GDP e Kosovës është 1.58 miliard euro dhe GDP për banorë është 658 Euro. Tabela 1.51 tregon se 30% e GDP është bujqësia, 60% është industria dhe 9% është turizmi. Pjesa dërmuese e punonjësve janë të angazhuar në sektorin e industrisë (41 %), tregtinë me pakicë dhe shumicë, (24.6 %), shërbime (20%) dhe ndërtimtari (13.4 %).

4.25. Bujqësia

Roli i bujqësisë në zhvillimin ekonomik të Kosovës është I konsiderueshëm edhe përkundër tokës së dobët bujqësore në krahasim me Evropën. Kontributi i bujqësisë në GDP ndryshon prej 22% (Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+) dhe 30% (Profili i Komunës së Prizrenit).

Në Profilin e Kosovës (2006) vlerësohet se 2/3 e punëtorëve janë të angazhuar në bujqësi dhe në vitin 2003 ajo ka marrë pjesë me 18 % në vlerën e eksportit të vitit 2003. Në Prizren, përafërsisht më shumë se 50% e popullatës jeton në viset rurale. Prandaj sektori i bujqësisë është një nga burimet më të rëndësishme të punësimit dhe të hyrave. 25 % e tokës së Prizrenit është e



pëllëshme me një sistem të vaditjes që mbulon 3.300 ha (Profili Komunal i Prizrenit, 2007).

Prizreni, në Jugosllavinë e dikurshme ka qenë e njohur për frutat e saja, perimet dhe verën.

Ne Prizren punojnë katër ndërmarrje për prodhime qumështore me kapacitetet e limituara prodhuese. Prodhimet qumështore, e sidomos djathi i Sharrit është i njohur edhe përtej kufijve të Kosovës. Prodhimi i drithrave në Prizren në vitin 2001 janë prodhuar 12.555 tone grurë dhe 15.040 tonë misër në Prizren.

Në Kosovë gjenden tri sisteme të vaditjes dhe të tria kontribuojnë në tokën bujqësore të Komunës së Prizrenit. 25 % e tokës së kultivuar është e lidhur me një nga tri sistemet të cilat janë: “Sistemi Dukagjini” i Prizrenit, “Sistemi i Radoniqit” i Gjakovës, dhe sistemet tjera lokale të kapacitetit të vogël.

4.26. Turizmi

Potenciali turistik i Kosovës është i lidhur ngushtë me pozitën gjeografike të vendit. Turizmi merr pjesë me 8-9% në GDP (Profili i Kosovës, 2006) me një potencial të shkëlqyeshëm turistik, si turizmi kulturor, turizmi natyror dhe turizmi dimëror. Kosova ka potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e turizmit dimëror në Malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna. Për momentin është vetëm një ski qendër - Brezovica e cila shfrytëzohet nga turistët lokal dhe ndërkombëtar që janë në Kosovë. Kosova ka po ashtu potencial për zhvillimin e turizmit të gjetisë. Ky lloj i turizmit mund të praktikohet në disa pjesë të Kosovës si: Rezervati I Kozhnjarit, Rusolia dhe Blinaja. Vlerat tjera natyrore të Kosovës janë Kanjoni i Mirushës, shpella e Gadimes, lumenjtë dhe liqet që ofrojnë mundësi për peshkatari, sportet e ujit dhe rekreacion (Profili i Kosovës, 2006).



5. TENDENCAT E MUNDSHME NË TË ARDHMEN, PA PLANIN (ALTERNATIVA “0”)

Alternativa zero («do-nothing case»), e cila është trajtuar në këtë kapitull, ka të bëjë me mosmiratimin për të zbatuar HZKP dhe si pasojë për të ruajtur gjendjen aktuale përsa i përket planifikimit të territorit në komunën e Prizrenit. Përveç "konflikteve të përdorimit të tokës," nuk përballohen ndotjet nga aktivitete shqetësuese. Njëkohësisht dhe paralelisht, HZ e Komunës së Prizrenit është një mjet për zhvillimin e Prizrenit, pasi në kushte të caktuara mund të kontribuojë për një planifikim gjithëpërfshirës strategjik, në bazë të kriterëve të zhvillimit të qëndrueshëm që përcakton prioritetet për zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e mjedisit, bazuar në nevojat dhe prioritetet e komunitetit lokal. Në përfundim, pa HZK, zhvillimi i qytetit të Prizrenit me rrethin do të jetë i fragmentuar dhe "anarkik", i mbështetur mundësisht vetëm në interesa dhe iniciativa private të rastit që nuk mbështeten në një planifikim strategjik të unifikuar. Rrjedhimisht, alternativa zero, dmth mungesa e një plani të përdorimit të tokës për territorin Komunës së Prizrenit, i cili do të organizonte zhvillimin e aktiviteteve ekonomike dhe do të kontribuonte në mbrojtjen e mjedisit, do të kishte si rezultat degradimin e mundshëm (të mëtejshëm), si të karakteristikave mjedisore edhe të atyre kulturore. Në paragrafët e mëposhtëm parashikohet zhvillimi i faktorëve të mjedisit në të ardhmen, pa zbatimin e HZK.

Përparsitë	Dobësitë
Me HZKP janë trajtuar të gjitha problemet dhe sfidat mjedisore; Kushte të përshtatshme fiziko-gjeografik, turizëm i zhvilluar dhe burime natyrore të mjaftueshme;	Mungesa e disa informatave për thellim të analizave për zhvillimet e planifikuara në kuadër të HZK; Shkall e lartë e ndërtimeve informale; Shpopullimi i zonav malore dhe përqëndrim i



<p>Interesim në rritje i qytetarve, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë civile për mjedisin; Legjislacion mjedisor dhe planifikimit hapsinor i zhvilluar dhe përmirësuar; Reduktim i dukshëm i industrive që ndikojnë në ndotjen mjedisore; Teknologji inovative në procese industriale dhe ndërtim; Fonde të konsiderueshme nga Qeveria /donatorët dhe nga sistemi i përmirësuar i të hyrave vetanake, komunikim i përmirësuar përmes transportit rrugor.</p>	<p>konsiderueshëm në zonat e ulta; Rrugë me përmbajtje jo të plotë (trotuar, parkingje, etj); Shkallë e konsiderueshme nga ndotja e ajrit nga sektori I transportit dhe amvisit; Motivim i ulët në segment të caktuar të administratës publike dhe qeverisjes lokale; Zvogëlimi i hapësirave të gjelbërta dhe hapësirave të tjera publike; Përqindje e lartë e papunësisë; Ndërtimi i banimit kolektiv pa norma të duhura urbanistike dhe ndërtimore; Mungesa e koordinimit me komunat për rreth; Infrastrukturë jo shumë e zhvilluar dhe e pabërtuar (jo shumë funksionale); Mënyshëm i dobët i mbeturinave; Mos trajtimi i hot spotëve mjedisorë; Mënyshëm jo i mirë i turizmit;</p>
<p>Mundësitë Planifikimi i masave për mbrojtje dhe zhvillim të mjedisit; Gadishmëri e donatorëve dhe qeverisë për trajtim të pikave të rrezikuara mjedisore; Zhvillimi i kapaciteteve menaxhuese të politikave, planeve dhe programeve në nivel urban; Rekomandime që të ketë një ndalim të plotë të qasjes së automjeteve të motorizuara</p>	<p>Kërcënimet Kërcënim për shëndetin e banorëve të Prizrenit nga ndotja mjedisore; Prishje e balancit mjedisor; Degradim i cilësisë së ajrit nga lëndët djegëse alternative në prodhimin e energjisë elektrike, trafikun e mbingarkuar në zonën e qytetit dhe deponive ilegale të mbeturinave; Shkatërrim i resurseve toksore, ujore dhe resurseve tjera;</p>



Komuna e Prizrenit
DUPH



<p>neper qendren e qytetit, si dhe si qasje selektive të rreptë ndaj automjeteve të mëdha që kalojnë nëpër zona urbane.</p> <p>Krijimi i një Forumi qytetar gjithë përfshirës për kualitet të jetës më të mire, si nje njësi për oponencë dhe edukim mjedisor;</p> <p>Rritja e efektshmërisë së zbatimit të Ligjeve dhe detyrimeve financiare të popullsisë dhe biznesit në raport me taksat urbane;</p> <p>Bashkëveprim i kordinuar me komunat tjera;</p> <p>Përfshirja e ekipeve të kualifikuara në zbatimin e planeve dhe hartimin e projekteve të rendësishme në kuadër të HZK;</p> <p>Ndërtimi i impjantit regjional dhe trajtimi i përkohëshëm në pikat e fundit të derdhjeve të ujit të përdorur;</p> <p>Ngritje e bashkpunimit ndërmjet palëve të përfshira me komunitetin lokal në gjetjen e zgjidhjeve më efikase.</p> <p>Përmirësimi i shërbimeve në transportin publik;</p> <p>Përfshirja e biznesit privat në hapsirat pyjore, të gjelbra dhe rekreative (parqe, salla lojrash, sipërfaqe për femijët).</p>	<p>Trajtimi i ujërave të zeza në zonën e Prizrenit është një shqetësim i madh, pasi që një sasi e konsiderueshme e ujërave të zeza derdhen në lumenj dhe në disa pjesë direkt në hapësirë të hapur, pa distilim.</p> <p>Shkatërrim i ekosistemeve, biodiversitetit, florës dhe faunës;</p> <p>Shkatërrim i trashëgimisë kulturore dhe natyrore;</p> <p>Keqpërdorimit i burimeve të ujit nga nxjerrjen e tepruar të rërës dhe zhavorrit në lumë, e cila shkakton degradimin e lumenjve;</p> <p>Konflikte në lidhje me çështjet e pronësisë;</p> <p>Pakësimi i hapsirave publike për shkak të presionit;</p> <p>Mungesa dhe/ose kosto e lartë për disponimin e sipërfaqeve të lira për projekte zhvillimore;</p> <p>Ulje e ndjeshme e biodiversitetit;</p> <p>Mungesa e koherencës midis aksioneve të shoqërisë civile dhe pushtetit vendor, donacioneve dhe departamenteve universitare/studiove profesionale etj</p>
--	--



5. PËRSHKRIM I PËRGJITSHËM I PLANIT

5.1. Qëllimi dhe objektivat e Planit

Qëllimi i Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit është të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e komunës, përcaktoj shfrytëzim të përshtatshëm të tokës, mbrojtje të mjedisit dhe ruajtje të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Harta Zonale Komunale është mjet për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të Planit Zhvillimor Komunal dhe për shtrirjen hapësinore dhe gjeografike të tyre ku në bazë të këtij plani. Harta Zonale e Komunës ofron elaboratin e hollësishëm të kufijve të zonave dhe kushteve zhvillimore për çdo zonë. Përveç parimeve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 4 të Ligjit Nr.04/L-174 dhe në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 24/2015, Harta Zonale duhet të hartohet në pajtim me parimet specifiketë përmendura më poshtë.

Me Hartën Zonale të Komunës do të bëhet harmonizimi i zhvillimit të hapësirës me dokumentet e planifikuara, duke ju përshtatur gjendjes ekzistuese, nevojave dhe mundësive reale të zhvillimit.

Harta Zonale e Komunës duhet të jetë e bazuar në Planin Hapësinor të Kosovës dhe interesat kombëtar të paraqitura si objektiva, plane dhe politika të qeverisë. Harta Zonale e Komunës merr parasysh mundësitë e integritit të Planeve Rregulluese Urbane që janë në fuqi. Harta Zonale e Komunës hartohet në përputhje me normat teknike të planifikimit hapësinor, në formën e cila e bën më të lehtë përdorimin dhe lehtëson monitorimin dhe rishikimin.

Harta Zonale gjithashtu përcakton masat e veprimeve duke u bazuar në afate kohore dhe projeksione financiare; mundëson lehtësim për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të Planit Zhvillimor Komunal; përfshin hartimin e elaboratit të hollësishëm për kufijtë e zonave dhe kushteve zhvillimore për secilën zonë duke u bazuar në harmonizimin e planifikimit zhvillimor,



Komuna e Prizrenit
DUPH



ndryshimeve në hapësirë, shfrytëzimit racional dhe human të hapësirës, resurseve në pajtim me ligjet, parimet dhe normat teknike.

Harta Zonale e Komunës është hartuar për tërë territorin e Komunës së Prizrenit. Në përmbushjen e këtyre qëllimeve, ky plan ka për qëllim të sjellë përfitime publike si tërësi, e jo përfitime për ndonjë person ose klasë të caktuar personash. Megjithëse përmes administrimit dhe zbatimit, përfitimet dhe dëmtimet do t'i gëzojnë apo pësojnë individë të veçantë. Prandaj, shkeljet e paqëllimshme të detyrimeve të administrimit dhe zbatimit me këtë plan, nuk do të jenë të detyrueshme për kundërvajtje.

E rëndësishme, Harta Zonale e Komunës së Prizrenit përfshin arsyetimin dhe sipërfaqet për të cilat do të hartohen planerregulluese të hollësishme, Planine Veprimit për Zbatim ku integrohen të gjitha projektet dhe veprimet e planifikuara, dispozitat për administrim, zbatim dhe monitorim të zbatimit të dokumentit.

5.2. Arsyetimi

5.2.1. Arsyetimi Ligjor, Mjedisor, Ekonomik, Financiar Dhe Social

Duke marrë parasysh që HZK-ja është dokument i planifikimit i bazuar në PZHK-në e komunës përkatëse, diskrepanca 7 vjeqare në mes të këtyre dy dokumenteve është vlerësuar si mjaft sfiduese gjatë hartimit. Për të hartuar një HZK sa më të saktë, gjatë ndarjes së territorit të komunës së Prizrenit në zona, si koncepti themelor i Hartës Zonale të Komunës, janë marrë për bazë parimet e zonimit të përcaktuara me nenin 5 të udhëzimit administrativ nr. 24/2015. Këto parime përfshijnë:

- Promovimin e objektivave të planeve zhvillimore sektoriale
- Promovimin e objektivave të komunitetit
- Promovimin e shëndetit dhe sigurisë publike dhe të mirëqenies së përgjithshme
- Sigurimin e llojllojshmërisë së shfrytëzimeve dhe dendësive
- Sigurimin e nevojave të interesit publik
- Sigurimin e zhvillimit të planifikuar të bazuar në :
 - gjendjen ekzistuese (marrë parasysh mjedisin e ndërtuar faktik dhe të drejtat pronësore),
 - nevojën për të formësuar dhe balancuar zhvillimin urban dhe rural,
 - karakteristikat natyrore të tokës,
 - kapacitetet ekzistuese dhe të planifikuara të shërbimeve,



Komuna e Prizrenit
DUPH



- vlerat natyrore dhe kulturore të komunës dhe
- çdo model të shfrytëzimit të tokës të bazuar në Planin Zhvillimor Komunal.

Gjithashtu, janë përditësuar të gjitha të dhënat duke përfshirë këtu edhe hartën e shfrytëzimit të tokës bazuar në gjendjen faktike në terren, planet sektoriale nga drejtoritë dhe institucionet përkatëse.

Arsyetimi për ndarjen zonale bazohet në 3 kritere bazë për identifikim të zonave:

1. Inventarizimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese, edhe atë:

- Integrimi i kërkesave të PZHK-së, mbrojtje të sipërfaqeve bujqësore, pyjore, kufijve të zonës urbane, vendbanimeve rurale, etj.
- Listimin/ evidentimin e zbatueshmërisë së të gjithë projekteve/ investimeve kapitale nga PZHK-ja.
- Nxjerrjen e kufirit të zonës urbane dhe kufijve për zhvillime të reja për zonën rurale/ fshatrat nga zonat e vendbanimeve dhe zonat e zhvillimit të ardhshëm të parapara me Planin Zhvillimor Komunal dhe duke integruar planet rregulluese që janë në fuqi ligjore
- Inventarizimin e të gjithë rrugëve ekzistuese, shfrytëzimeve të parcelave, ndërtimeve (perimetri dhe etazhiteti) ekzistuese në zonën urbane dhe rurale.
- Inventarizimi I të gjithë ndërtesave/ parcelave me shfrytëzim infrastrukturë publike dhe sociale, dhe kalkulimin e nevojave të ardhshme për infrastrukturë publike dhe sociale sipas normave teknike të planifikimit hapësinor;
- Diskutime të hapura me qytetarë/ Mbajtja e takimeve të hapura me qytetarë në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor.

2. Klasifikimi dhe analiza e strukturave të vendbanimit dhe dinamika socio-ekonomike e komunës.

3. Potencialet për zhvillimin të ardhshëm.

- Analizë të banorëve në Prizren për secilin vendbanim, koncentrimin në lagje, migrimit, etj.
- Kukulimin e densitetit ekzistues të banorëve në zonën urbane dhe vendbanimeve rurale dhe analiza e shtimit të fondit ndërtimor kundrejt densitetit



Komuna e Prizrenit
DUPH



maksimal të banorëve të përcaktuar në PZHK;

- Analizimin e të gjithë parcelave kadastrale në zonën urbane sipas pozicionit, madhësisë, formës dhe qasjes
- Kalkulim të shtrirjes së shfrytëzimeve të tokës, densitetit të banorëve, intensitetit të zhvillimit dhe fondit ndërtimor, etj. dhe integritit të gjendje ekzistuese.
- Analizë e kapacitetit ekzistues ndërtimor vs të lejueshëm sipas PZHK- së.
- Analizë e kapacitetit pranues të zhvillimit/ ndërtimeve të ardhshme në zonën urbane.

Edhe pse qyteti karakterizohet nga një fond ndërtimor mjaft homogjen, fakti që janë zhvilluar në mënyrë spontane, paraqitet nevoja të përcaktohen dhe theksohen karakteristikat kryesore të këtyre zonave të ndryshme brenda vendbanimeve si mjet për të forcuar karakterin e tyre. Gjithashtu, për gjithë zonën urbane është propozuar zhvillim për secilën prej zonave përmes të cilave synohet përmirësimi dhe promovimi i tipareve dhe resurseve.

Përveq obligimeve të derivuara nga PZHK-ja, janë integruar edhe Planet Rregulluese Urbane të cilat kanë dëshmuar zbatim të suksesshëm dhe që janë në fuqi ligjore, bazuar në UA nr. 24/2015 neni 5, pika 5, ku parashihet mundësia e integritit të këtyre planeve në fuqi.

Për shkak se në shumë raste, ndarjet zyrtare të parcelave kadastrale nuk korrespondojnë aspak me gjendjen fizike dhe faktike në terren, për analizë dhe propozim të zhvillimit të ri, jemi bazuar edhe në kriterin e morfologjisë urbane fizike në terren (duke u bazuar në Ortofoton e Prizrenit të vitit 2018).

Përveç tjerash, gjendja ekzistuese është konsideruar si parim kyç për përcaktimin e sipërfaqeve ndërtimore, duke zgjeruar këto sipërfaqe edhe përtej kufijve të parashikuar me PZHKP. Me këtë zgjerim të sipërfaqeve ndërtimore në zonat rurale, planifikohet zhvillimi i kontrolluar i zonave të shfrytëzuara për ndërtim në këto zona, duke ofruar kushte më të mira për jetesë dhe infrastrukturë të përshtatshme për shfrytëzim nga banorët e vendbanimeve rurale.

5.2.2. Arsyetimi i ndarjes së zonave mbishtresore

Në rastet kur në kuadër të territorit të komunës ka nevojë për të vendosur kushte zhvillimore apo masa mbrojtëse mbi një sipërfaqe të veçantë të komunës, atëherë përdoret koncepti i mbishtresimit, gjegjësisht përcaktohen zona mbishtresore.

Zonat mbishtresore dallojnë nga zonat. Zonat mbishtresore janë një sërë rregullash plotësuese



Komuna e Prizrenit
DUPH



ose më strikte mbi një sipërfaqe të veçantë (si p.sh. një sipërfaqe me rrezikshmëri nga vërshimet) të vendosura 'përmbi' kushtet e zonës bazë. Një zonë mbishtresore mund të mbulojë tërë sipërfaqen e një zone, një pjesë të saj, apo më shumë zonave, ose mund të ketë kufij të ndryshëm nga të gjitha zonat që prekë/mbivendoset.

5.2.3. Arsyetimi për zhvillimin dhe zbatimin e planit të veprimt që rrjedh nga plani zhvillimor komunal

Sipërfaqja e tokës apo ndërtesave të shfrytëzuara si dytësore në një parcelë kadastrale, nuk duhet të tejkalojë sipërfaqen e tokës apo ndërtesës së shfrytëzimit kryesor, në të njëjtën parcelë kadastrale.

5.3. Lista e Zonave

Tabela 2. Kategoritë kryesore të zonave që paraqiten në kuadër të zones urbane janë:

KATEGORITË E ZONAVE	SIMBOL
Zona Banimi me Intensitet të Ulët	
Zonë Banimi Rural	ZB – R
Zona Banimi me Intensitet të Ulët dhe të Mesëm	
Zonë Banimi 1	ZB-1
Zonë Banimi 2	ZB-2
Zona Banimi me Intensitet të Lartë	
Zonë Banimi 3	ZB-3
Zonë Banimi 4	ZB-4
Zonë Banimi e Mbrojtur	
Zonë Banimi e Mbrojtur 1	ZB-M1
Zonë Banimi e Mbrojtur 2	ZB-M2
Zona Komercale	ZK
Zona për Shfrytëzim të Përzier	
Zonë për shfrytëzim të Përzier	ZSHP
Zonë për Shfrytëzim të Përzier – I	ZSHP-I
Zona të Shërbimeve	
Zonë e Shërbimeve	ZSH
Zonë e Shërbimeve - Varreza	ZSH- V
Zonë e Shërbimeve – Parqe Publike dhe Hapësira të Hapura	ZSH-P
Zona Industriale	ZI
Zona Bujqësore	Zb
Zona Pyjore	ZP
Zona e Veçantë – Parku Kombëtar Mali Sharr	ZV
Zonë e Veçantë e Mbrojtur – Qendra Historike e Prizrenit	ZVM
Zonë Teknologjike	ZT



Komuna e Prizrenit
DUPH



Zonë Ushtarake e Sigurisë	ZuS
Zonë Rekreative - Turistike	ZrT
Zonë e Interesit dhe Mbrojtjes Shtetërore	ZIMS



6. PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE

6.1. Objektivat e VSM-së për Hartën Zonale Komunale të Prizrenit

Duke u bazuar në qëllimin e VSM-së, që përkon edhe me qëllimin e mbrojtjes mjedisore të vetë HZK-së së Prizrenit, janë përcaktuar objektivat mjedisore të VSM-së. Edhe objektivat mjedisore qëndrojnë po njëjloj për Planet e niveleve tjera. Për më tepër, këto objektiva janë ndërtuar në përputhje me politikat e strategjitë mjedisore kombëtare, me Planin Hapësinor të Kosovës, si dhe me qëndrimet e sektorëve përkatës (që preken nga objektivat). Për çdo objektiv janë listuar ndikimet e mundshme të Planit në mjedis, nëse objektivi nuk realizohet, pra nëse nuk merren masat zbutëse, eliminuese apo parandaluese të dëmit mjedisor.

Sipas rëndësisë së tyre, objektivat mund të ndahen në objektiva primare apo globale dhe në objektiva lokale të nivelit komunal. Objektivat kryesore të shqyrtimit të gjerë që lidhen me këtë plan mund të jetë i definuar si:

Objektivi Mjedisor 1 (OM1) – Ajri: Përmbushja e objektivave afatmesme për sasi të vjetore të shkarkimeve të ndotësve, sipas kufijve maksimalë e normave të lejuara nga Bashkimi Europian.

Objektivi Mjedisor 2 (OM2) – Uji: Zbutja, kufizimi dhe parandalimi i efekteve negative të aktivitetit njerëzor në territorin e komunës së Prizrenit, mbi burimet dhe trupat ujorë sipërfaqësorë e nëntokësorë, përfshirë ujin e pijshëm, lumenjtë dhe liqenet.

Objektivi Mjedisor 3 (OM3) – Toka: Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës dhe burimeve natyrore të lidhura drejtpërdrejt me të.

Objektivi Mjedisor 4 (OM4) – Biodiversiteti: Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit në funksion të ruajtjes së ekosistemeve, shërbimeve të tyre dhe garantimit të aftësisë vetëripërtëritëse të mjedisit.

Objektivi Mjedisor 5 (OM5) – Pyjet: Konservimi, shtimi dhe manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve në funksion të garantimit të aftësisë vetëripërtëritëse të ekosistemit, zbutjes së efekteve të



Komuna e Prizrenit
DUPH



ndryshimeve klimatike dhe ofrimit të një burimi të qëndrueshëm jetese për banorët e zonave rurale.

Objektivi Mjedisor 6 (OM6) – Peizazhi dhe Ekosistemet: Konservimi dhe manaxhimi inteligjent i peizazhit, si matricë bazë për sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve të ekosistemeve.

Objektivi Mjedisor 7 (OM7) – Ndryshimet klimatike: Realizimi i masave dhe infrastrukturës për të mos kontribuar në ndryshimet klimatike dhe efektin serë, si dhe për të parandaluar, apo zbutur efektet negative nga ndryshimet klimatike, në përmbushje edhe të angazhimeve përkatëse kombëtare.

Objektivi Mjedisor 8 (OM8) – Trashëgimia kulturore: Konservimi e restaurimi për jetëgjatësi i objekteve dhe zonave historike e të trashëgimisë kulturore e arkeologjike.

Objektivi Mjedisor 9 (OM9) – Cilësia e jetës: Garantimi i zhvillimit social dhe ekonomik në harmoni me mjedisin dhe burimet natyrore.

Objektivat strategjike të mësipërme synojnë përmirësimin e cilësisë së jetes në komunë (rritja e sigurisë, shtim i mundësive për menyre aktive të jetesës, shtim i sipërfaqeve të gjelbra, përmirësim i cilësisë së ajrit, etj.). Ato duhen shoqëruar me veprime operationale konkrete që çojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të planit.

VSM-ja e HZKP, parashikon kushte dhe masa zhvillimore për Komunën e Prizrenit, si një e tërë me vendbanime, lagjet, e deri tek zonat e vogla të banimit. Në këtë fazë, Projekti i Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit, do jepen kufijt, kriteret, intensitetet, densitetet dhe standartet e parashikuara për tërë komunën që nënkupton edhe refleksion në çdo vendbanim përmes kushteve zhvillimore dhe masave tjera. HZKP do të përfshijë kushtet zhvillimore dhe masat për menaxhimin e pronës në menyre adekuate pa dallime të pronarve gjatë dhënies së kushteve në zona ndërtimore, gjelbrim etj. Sfidues është fakti nga se sa do të të analizohet ndikimi i këtij projekti në korridoret e qarkullimit të shtazëve ose a janë marrë masa të duhura për qarkullim natyrorë të shtazëve dhe llojeve bimore nga një habitat në tjetrin, pyllzimin, ripyllëzimin, krijimin e disa shiritave të gjelbër, tampon zonave, parqeve, etj. Këto zona apo vija të infrastrukturës përmenden vetëm në pjesën strategjike. Një sfidë e veçantë mbetet zbatimi në praktike i këtyre kushteve të HZK-së; për pyllëzim, ripyllëzim, shirita të gjelbër, dhe në



përgjithësi shtimin e hapësirave të gjelbra, krijimi i zonave rekreative dhe permiresimi i treguesve mjedisore të komunës.

Gjithashtu HZK synon të integroje dhe përmirësoje situatën aktuale komunale, si psh. zgjerimi i vendbanimeve në drejtimin më të favorshëm në kuptimin e shtrirjes në tokë më plleshmëri të dobët dhe me përdorim të perzier.

Një tjetër aspekt mjedisor i HZK-së është masat për rehabilitimin e pikave të nxehta mjedisore (duke mos specifikuar sakt lokacionet e pikave të nxehta mjedisore por kjo është trajtuar si problem).

Në mënyrë të përmbledhur objektivat për mbrojtjen e mjedisit në kuadrin e Planit për HZKP, mund të përmbledhen si më poshte:

1. Pakesimi i sasisë së mbetjeve dhe manaxhimi i integruar i tyre;
2. Krijimi i një komune të qëndrueshme dhe të shëndetshme;
3. Identifikimi dhe krijimi i habitatve të reja, dhe korridoreve të gjelbra;
4. Permiresimi i cilësisë së ajrit, përfshirë edhe reduktimin të emisioneve në ajër dhe eliminimin e zhurmës;
5. Kursimi i energjisë dhe paksimi i emisioneve të gazeve serrë;
6. Cilësia e ujërave sipërfaqesore në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Kosovës dhe Direktivave të BE-së;
7. Reduktimi i intensitetit të trafikut nëpërmjet promovimit të transportit publik, këmbësor dhe qarkullimit me bicikleta;
8. Shtimi dhe mbrojtja e vlerave kulturore, përfshirë arkeologjike dhe arkitekturore;
9. Konservimi dhe shtimi i zonave dhe elementeve peizazhistik;
10. Mbrojtja e mjedisit natyror në pyjet dhe malet;
11. Ripërdorimi i disa tokave të ndotura në vend të tokave të reja.

6.2. Projekt-Raporti perfundimtar

Raporti Përfundimtar do të jetë rezultati kryesor raportues i procesit të VSM-së. Mbas shqyrtimeve dhe komenteve të komunës, si edhe seancave të dëgjësive me publikun, do shihen pyetjet, komentet apo sugjerimet që dalin gjatë procesit, do u jepet përgjigje dhe do integrohen



Komuna e Prizrenit
DUPH



nese gjykohej të drejta, dhe në fund do të prodhohet Raporti Përfundimtar për miratim nga Komuna dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

6.3. Roli dhe natyra e Hartës Zonale Komunale

Harta Zonale Komunale e Prizrenit është dokument i cili përmes kushteve zhvillimore dhe masave përcaktone drejtimet e zhvillimit të komunës duke marrë parasysh interesat e përbashkëta të banorëve të Komunës së Prizrenit për një mirëqenie dhe një zhvillim ekonomik, duke përmirësuar kualitetin e jetes se banorëve të vet. HZK kujdes të veçantë i kushton vlerave të trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore dhe mbron resurset e këtij territori. Planifikimi hapësinor duhet të ketë rolin udhëheqës në zhvillimin e gjithëmbarsuem prandaj kjo Harta Zonale Komunale e Prizrenit do të përbëjë udhëzuesin bazë për:

- ✓ *Identifikimin e lokacioneve me potencial të zhvillimit hapësinor në komunën e Prizrenit.*
- ✓ *Përcaktimin politikave përmes kushteve zhvillimore dhe masat që i jep lidhur me shpërndarjen hapësinore të funksioneve të banimit, industrisë, shërbimeve, turizmit, zhvillimit rural dhe politikave në mbrojtjen e vlerave të trashëgimive kulturore, historike dhe natyrore.*
- ✓ *Identifikimin e rolit të vendbanimeve kryesore dhe veçanërisht të qytetit të Prizrenit si qender administrative - duke kontribuar në zhvillimin e pergjitheshem ekonomik, social dhe mjedisor të kesaj komune.*

Harta Zonale Komunale përmes një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës të planifikimit të integruar:

- ✓ Përcakton mënyrën dhe drejtimet e vendosjes së popullsisë, punësimin dhe shfrytëzimin e resurseve natyrore për t'i shërbyer,
- ✓ Orienton dhe lehtëson vendimet politike për investimet publike në infrastrukturë teknike dhe sociale,
- ✓ Përkrah zhvillim të balansuar në mes të zonave urbane dhe zonave rurale dhe me shkallë të ndryshme ekonomike,
- ✓ Identifikon lokacionet me potencial të zhvillimit hapësinor të komunës.



6.4. Kriteret mjedisore qe kufizojne Zhvillimin Komunal

Më poshtë paraqiten disa kriteret mjedisore që duhet të kufizojnë zhvillimin komunal, të grupuara në katër kategori kryesore, përkatesisht (1) kriteret e forta mjedisore-shëndetsore, (2) kriteret të trashëgimisë kulturore, (3) kriteret peisazhike dhe (4) kriteret inxhinierike dhe të infrastrukturës.

6.5. Kriteret e forta mjedisore-shëndetësore

Këto kategori kriteresh përcaktojnë zonat e përjashtuara nga zhvillimi komunal. Kriteret e forta përfshijnë (I) zona me vlera të veçanta mjedisore (psh. zonat e mbrojtura të natyrës), (II) zona të rrezikshme për zhvillim, dhe (III) zona të ndotura të njohura si “hot-spote” mjedisore (psh. mbetje kimike).

Zonat e mbrojtura

Lidhur me zonat e mbrojtura natyrore, Parku Kombëtar Sharri është zona më e madhe dhe më e rëndësishme e mbrojtur jo vetëm në Prizren por edhe më gjerë. Parku Kombëtar Sharri i themeluar në vitin 1986 ishte i vetmi Parku Kombëtar në Kosovë. Parku Kombëtar Sharri dallon me vlera botanike, shtazore, ekologjike, turistike, rekreative, sportive, edukative dhe kulturore. Parku është aq i pasur me biodiversitet jo vetëm në Kosovë por edhe në gadishullin Ballkanik, dhe përfaqëson një thesar të llojeve bimore ku disa prej tyre janë endemike, të rralla ose të rrezikuara nga shfarosja. Nuk lejohen ndërtime në zonat e mësipërme që bartin vlera të veçanta mjedisore.

Zonat e rrezikshme për zhvillim përfshijnë:

1. Zonat e rrezikuara nga vërshimet dhe erozioni
2. Shtretërit e lumenjve dhe pjesët buferike rreth tyre
3. Basenet nentokësore ujëmbajtëse;
4. Zonat me pjerresi më të madhe.

Nuk lejohen ndërtime në (apo pranë) shtretërve të lumenjve pasi ndërtime mund të jenë në zonën e përmytjeve (qofte dhe shumë të rralla), mund të shkaktojnë erosion të brigjeve, si dhe të cenojnë rregjimin hidrologjik të sistemit ujor.



Në mënyrë të ngjashme, nuk lejohen ndertimet ne zonat me pjerresi të madhe pasi në mjedis argjilor këto ndërtime mund të shkaktojnë (ose përkeqesojnë) situatë erodive të kodrave dhe janë një rrezik publik i përhershëm.

(II) Zona të ndotura të njohura si “hot-spote” mjedisore (psh. mbetje kimike) përfshijne:

1. Hotspote nga kemikatet;
2. Hotspote nga aktivitetet bujqësore;
3. Hotspote nga sektori i transportit;
4. Hotspote nga deponitë sanitare;
5. Hotspote nga sektori i industries;
6. Hotspotet nga sektori minerar;
7. Hotspote nga materiet radioactive.

Këto zona duhet të jenë objekte të studimeve për vlersimin e situates mjedisore mbi bazën e të cilit do te mund të gjykohet mbi nivelin e ndotjës së ujit dhe tokës dhe masat eventuale që duhen ndërrmarre për rehabilitimim.

6.6. Kriteria të trashëgimisë kulturore

Qyteti i Prizrenit gjithmonë ka qenë udhëkryq i kulturave dhe i grupeve të ndryshme etnike dhe prandaj Prizreni pasqyron një histori të mrekullueshme të territorit të Kosovës. Ekzistojnë shumë ndërtesa të rëndësishme monumentale të trashëguara nga civilizime të ndryshme, posaçërisht nga epoka Otomane, kur qytetit fitoi rëndësi të madhe si qytet tregtar përparimtar duke ju falënderuar pozitës së tij strategjike. Ekzistojnë 291 monumente dhe lokacione kulturore në Komunën e Prizrenit, të cilat janë të regjistruara nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve (2009). Qyteti i Prizrenit ka shumicën dhe llojllojshmërinë më të madhe të monumenteve dhe të lokacioneve që paraqesin sfondin historik të territorit të tij. Në Komunën e Prizrenit si klasifikim monument arkitektonik janë 50 ndërtesa publike të cilat janë në shfrytëzim dhe / ose pronësi të palëve publike ose shtetërore.



7. NJOHJA DHE PARASHIKIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE

7.1. Ndikimet mjedisore

Qëllimi i VSM-së është, ndër të tjera, të njohë, të parashikojë dhe të vlerësojë pasojat e Planit në mjedis dhe merret parasysh në kuptimin e tij të gjerë, nga këndvështrimi ekologjik, social dhe ekonomik. Plani formulon një vizion për Komunën e Prizrenit, Objektivat Strategjike që i shërbejnë këtij vizioni, si edhe Prioritetet për çdo Objektiv Strategjik Prioritet e përgjithshme përfshijnë vepra teknike infrastrukturash, vepra infrastrukturash sociale, vepra zhvillimore, veprime për mbrojtjen e mjedisit natyror dhe kulturor, veprime për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, etj. Të gjitha këto propozime të Planit pritet të kenë ndikim në mjedis dhe të ndikojnë në shkallë të vogël ose të madhe, pozitivisht ose negativisht, në parametrat e ndryshme mjedisore (toka, ujërat, ajri, faktorët klimaterikë, biodiversiteti, etj).

Në paragrafët e mëposhtëm, siç u përmend edhe më parë, shqyrtohet marrëdhënia e secilit Prioritet të Projektit të propozuar me secilin faktor mjedisor, siç ata përcaktohen në Ligjin për "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor".

Prioriteti 1 që ka të bëjë me mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, lidhet me faktorët e mëposhtëm mjedisorë:

Lidhet me tokën, për shkak se menaxhimi, sasia dhe cilësia e burimeve natyrore (burime minerale, zonat e mbrojtura natyrore) ndikojnë në cilësinë, sasinë dhe në mbrojtjen e tokës, ndërsa vet toka në vetvete është një burim natyror i cili shfrytëzohet p.sh. në sektorin bujqësor po edhe në vendosjen e çdo aktiviteti antropogjen dhe propozon veprime që në mënyrë indirekte ndikojnë në të.

Lidhet me biodiversitetin pasi vendoset në burime natyrore si pyje, toka, ujë dhe përcaktohet nga cilësia dhe sasia e tyre.



Lidhet me mbetjet sepse mënyra e menaxhimit të tyre ka pasoja në burimet natyrore (p.sh. hedhje të mbetjeve në mjedis dhe shkatërrimi i tyre nga organizma të gjalla apo bimore), por edhe e kundërta, menaxhimi i burimeve natyrore krijon mbetje (p.sh. aktivitetet e nxjerrjes shfytëzimit dhe seperimit të gurit gëlqeror).

Shfrytëzimi i një burimi natyror përbën burim ekonomik për pjesë të popullsisë apo edhe produkt konsumi jetese. Prioriteti 1 parashikon menaxhimin racional të burimeve natyrore, në mënyrë që ata të mos zhduken në të ardhmen apo të krijojnë kushte të vështira jetese për popullsinë e Komunës.

Nxjerrja e pakontrolluar e gurëve dhe prerja e pemëve, si edhe mbi kullotja janë aktivitete që kanë pasoja në peisazh, duke ndryshuar p.sh. morfologjinë e tij, hidrografinë e tij si edhe bimësinë në një hapësirë peisazhi të caktuar. Si rrjedhim, Prioriteti 1 lidhet me peisazhin dhe parashikon mirëmbajtjen e tij apo përmirësimin e tij. Për sa i përket ajrit, faktorëve klimatikë, ujërave, zhurmave dhe trashëgimisë kulturore, nuk është e mundur për tu përcaktuar ndikimi i Prioriteti 1 tek faktorët konkret mjedisorë.

Prioriteti 2 që ka lidhje me mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të ekosistemeve pyjore, ka lidhje me faktorët e mëposhtëm mjedisorë:

Lidhet me tokën, pasi marrëdhënia midis ekosistemeve pyjore dhe tokave është e dyanshme.

Tokat mbështesin ekosistemet pyjore dhe ekosistemet pyjore mbrojnë tokën.

Lidhet me ajrin pasi pyjet filtrojnë ndotësit atmosferikë dhe përmirësojnë cilësinë e ajrit

Lidhet indirekt me faktorët klimatikë dhe në veçanti me mikroklimën e zonës në të cilën rriten dhe zhvillohen.

Lidhet me biodiversitetin, pasi pyjet posedojnë shumicën e florës dhe faunës së Komunës.

Lidhet me peizazhin dhe veçanërisht me peizazhin natyror, me veprime që e mbrojnë atë.

Ekosistemet pyjore janë pjesë e peizazhit natyror.

Lidhet me popullsinë dhe asete fizike në masën që ekosistemet pyjore përdoren në prerjen e drurëve dhe zhvillimin turistik të butë (Organizim të shëtitjeve dhe korridoreve të çiklizmit) dhe si rrjedhim në masën që mbështesin ekonominë lokale.

Për sa i përket ujit, zhurmës, mbetjeve dhe trashëgimisë kulturore, nuk është e mundur të përcaktohet një ndikim i Prioritetit 2 për këta faktorë konkretë mjedisorë.



Komuna e Prizrenit
DUPH



Prioritetit 3 që ka të bëjë me mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, është i lidhur me faktorët e mëposhtëm mjedisorë:

Lidhet me tokën, sepse kjo mund ose nuk mund të akomodojë burimet e ujit dhe për shkak se ujit mund të dëmtojë tokën.

Lidhet me ujin, pasi të gjitha veprimtaritë kanë të bëjnë me përdorimin dhe shfrytëzimin e tij në dobi të sektorëve primar, sekondar dhe terciar, si dhe shëndetin e njeriut.

Menaxhimi efektiv i burimeve të ujit do të ketë si rrjedhim të mos shfaqen dukuri mbishfrytëzimi të ujit dhe privimi të tij në zona kritike për ruajtjen e biodiversitetit. Për më tepër, infrastruktura antropogjene si për shembull rezervuarët, përdoren për ujitje, janë vende akomodimi të një faunë dhe flore të pasur. Si rrjedhim, ekziston një lidhje në mes të Prioritetit 3 dhe biodiversitetit.

Lidhet me popullsinë dhe asetet fizike pasi uji është një pasuri e përbashkët që i përket të gjithë njerëzve pasi cilësia e tij ndikon në shëndetin e popullsisë ndërsa sasia e tij ndikon në standardin e tyre të jetesës.

Menaxhimi efektiv i burimeve ujore nënkupton infrastrukturën që ndikojnë në peizazh, si për shembull ndërtimi i rezervuarëve artificialë dhe sistemit të tubacionit të ujitjes.

Për sa i përket ajrit, faktorëve klimatikë, mbetjeve, zhurmës dhe trashëgimisë kulturore, nuk është e mundur të përcaktohet ndikimi i Prioritetit 3 në këta faktorë konkretë mjedisor.

Prioritetit 4 ka lidhje me mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore, është i lidhur me faktorët e mëposhtëm të mjedisit:

Lidhet me tokën pasi toka bujqësore përbën pjesë të saj në gjithë sipërfaqen e Komunës dhe për këtë arsye të gjitha veprimet ndikojnë drejtpërdrejtë në të.

Lidhet me ujin, pasi për të është një depozitë, që e jep tek bimët, kur ato e kanë nevojë atë dhe pasi ky prioritet parashikon menaxhimin e ujit për ujitje ai parashikon ngopjen e tokës bujqësore vetëm me sasinë e nevojshme për ujë.

Lidhet me mbetjet, pasi një pjesë e tyre mund të shfrytëzohen (mbetjet organike) dhe të përdoren në tokën bujqësore me qëllim pasurimin e saj me lëndë organike.

Toka bujqësore është një aset për një pjesë të popullsisë që e ka në atë në pronësi dhe ushtron aktivitet në sektorin primar ndërsa pjelloria e saj përcakton gjendjen e tij financiare. Për këtë



arsye, është i lidhur me popullsinë, pasi synon mbajtjen e popullsisë në rajon dhe përmirësimin e standardit të tyre të jetesës.

Toka bujqësore përbëhet nga zonat gjysmë-natyrore të përbëra nga mbjellje lineare pemësh frutore, tarraca në shpatet e pjerrëta, fusha dhe parcela katrore dhe në formë mozaikësh të mbjella me kultura etj kufizohet nga kanalet e ujitjes, shirita toke të pakultivuara, përrenj natyrorë. Si rrjedhim përbën pjesë të peizazhit dhe gjendja e tij reflektohet në të.

Për ajrin, faktorët klimatike, biodiversitetin, zhurmën dhe kulturën nuk përcaktohet ndonjë ndikim në faktorët konkretë mjedisorë.

Prioritetit 5 që ka lidhje me edukimin mjedisor të komunitetit lokal, lidhet me faktorët e mjedisit si në vijim:

Lidhet me tokën, pasi me edukimin mjedisor shoqëria lokale do të adaptojë praktikat bujqësore që e mbrojnë dhe e ruajnë atë.

Lidhet me ujin pasi me edukimnt mjedisor komuniteti lokal do të mësojë përdorimin racional të ujit dhe në të njëjtën kohë, do të jetë e mundur marrja e masave për të mbrojtur pronat e tyre nga përmbytjet dhe fatkeqësitë e tjera natyrore që lidhen me ujin.

Lidhet me mbetjet, pasi me edukimin mjedisor komuniteti lokal do të mësojë të menaxhojë mbetjet shtëpiake në favor të tij (p.sh. ndarja e mbetjeve organike në burim, riciklimi i materialeve të ndryshme etj).

Lidhet me popullsinë dhe asetet aktive, pasi gjithë veprimet kërkojnë përfshirjen e gjithë komunitetit lokal, i cili përmirëson nivelin njohës, dhe përfshihet në mënyrë aktive në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe shfrytëzimin e aseteve të tij.

Për sa i përket ajrit, faktorëve klimatikë, biodiversitetit, zhurmave, trashëgimisë kulturore dhe peisazhit, nuk është e mundur për tu përcaktuar ndikimi i Prioritetit 5 tek faktorët mjedisor.

Prioritetit 6 që ka lidhje me zhvillimin turistik të rajonit, ka lidhje me faktorët e mëposhtëm mjedisorë :

Lidhet me tokën, pasi ajo përbën pritësin e aktiviteteve agroturistike, dhe në mënyrë të veçantë gjithë veprimet e propozuara që kanë lidhje me praktikat bujqësore dhe veprimet e tjera të lidhura me njësitë agroturistike.



Komuna e Prizrenit
DUPH



Lidhet me ajrin pasi synon rritjen e vizitorëve në monumente kulturore dhe natyrore të Prizrenit dhe si pasojë do të rritet edhe lëvizja e transportit privat dhe publik për/dhe nga monumentet. Në varësi të formave alternative të turizmit mund të përdoren mjete të ndryshme transporti, me më pak ose më shumë shkarkime të ndotësve në atmosferë.

Lidhet me ujërat, pasi do të sjellë ndryshime në kërkesën për ujë, me një kërkesë paralele për një menaxhim më racional të tij, kështu që pritet të ndikojë në burimet ujore sipërfaqësore.

Lidhet me mbetjet, pasi do të sjellë ndryshime në sasinë e mbeturinave të prodhuara, për arsye të turizmit dhe për këtë arsye do të ketë nevojë për menaxhimin e duhur.

Lidhet me zhurmën, pasi lëvizjet dhe përqëndrimet e turistëve pritet të shkaktojnë zhurmë, kështu që do të ketë ndikim në mjedisin akustik.

Lidhet me peizazhin, pasi elementët e trashëgimisë kulturore përbëjnë pjesë përbërëse të peizazhit, edhe zhvillimi i formave alternative të turizmit është i lidhur me peizazhin.

Lidhet me trashëgiminë kulturore, pasi në të do të bazohet një pjesë e madhe e potencialit të ardhshëm turistik të Komunës.

Prioriteti 6 parashikon rritjen e ekonomisë lokale dhe si rrjedhim, lidhet me standardin e jetesës së banorëve dhe me gjendjen e tyre financiare. Nga një këndvështrim më i gjerë, kjo do të ketë ndikim edhe në rritjen e popullsisë së Prizrenit, pasi krijimi i vendeve të reja të punës do të ndikojë në fenomenin e migrimit, veçanërisht të të rinjve.

Përsa i përket faktorëve klimatikë dhe biodiversitetit, nuk është i mundur përcaktimi i ndikimit të Prioritetit 6 në faktorët konkret mjedisor.

Prioriteti 7 ka të bëjë me modernizimin dhe forcimin e prodhimit primar, është i lidhur me faktorët e mëposhtëm mjedisorë:

Lidhet me tokën, sepse kjo është baza për zhvillimin e prodhimit primar pasi mbështet dhe ushqen bimët u kultivuar, dhe ndërkohë pranon praktikatat bujqësore të ndryshme, të mira apo të këqija.

Lidhet me ujin pasi prodhimi primar rrit kërkesën për ujë edhe nëse ai është përdorur për ujitjen e kulturave apo si ujë i pijshëm për bagëtinë, por edhe për shkak se në qarkullimin e ujit përfundojnë mbetjet nga përdorimi i pesticideve dhe plehrave kimike.



Komuna e Prizrenit
DUPH



Lidhet me biodiversitetin në atë masë që do të miratohet apo jo multikultivimi i produktet lokale dhe bujqësisë organike, si edhe në masën që sektori primar do të përhapet në hapësirën e rajonit të Prizrenit.

Lidhet me mbetjet pasi sektori primar prodhon mbetje por edhe mund ti shfrytëzojë mbetje si për shembull mbetjet organike të ngurta urbane të cilat përmes procesit të kompostimit mund të përdoren për pasurimin e tokës bujqësore me material organik.

Lidhet me popullsinë dhe me asetet fizike, pasi kërkon një minimum të fuqisë punëtore dhe përmasë popullsie, me synim që sektori primar të zhvillohet më tej, ndërsa kërkon edhe investime në makineri, magazina, sera, etj, duke ndikuar kështu në faktorin e aseteve fizike.

Lidhet me peizazhin, pasi zhvillimi i sipërfaqeve të tokës bujqësore, krijon imazhe karakteristike të zonave gjysmë natyrore të përbëra nga pemishte të mbjella në mënyrë lineare, tarraca në shpate të pjerrëta, parcela katrore në ultësira të mbjella me kultura bujqësore etj që kufizohen nga kanale ujitëse, parcela të pakultivuara, shirita të papunuara, përrrenjë natyrorë, elementë ndërtimi të peizazhit rural.

Përsa i përket ajrit, faktorëve klimatik, zhurmën dhe trashëgiminë kulturore, nuk ka asnjë provë të një impakti të këtij prioriteti mbi këta faktorë mjedisor.

Prioriteti 8 lidhet me forcimin e sektorit dytësor dhe tregtisë, shoqërohet me faktorët e mëposhtëm mjedisorë:

Lidhet me ajrin pasi tregtia është drejtpërdrejt e lidhur me sektorin e transportit dhe ndotjen e ajrit;

Lidhet me ujin që do të përdoret në impiantet e përpunimit p.sh. në pastrimin e produkteve bujqësore;

Lidhet me mbeturinat, pasi impiantet e përpunimit do të prodhojnë mbeturina, lëndë të ngurta ose lëngje që duhet të menaxhohen;

Lidhet me zhurmën e shkaktuar nga njësitë e përpunimit, por natyrisht varet nga madhësia e njësisë, nga pajisjet mekanike dhe nga produkti i prodhuar. Sidoqoftë, është fakt përdorimi i makinerive në njësitë e përpunimit.

Lidhet me popullsinë dhe me asetet fizike, pasi ky prioritet synon rritjen e ekonomisë lokale dhe si rrjedhim rritjen e standardit të jetesës së banorëve, dhe si rrjedhim rritjen dhe përmirësimin e



Komuna e Prizrenit
DUPH



gjendjes së tyre financiare, ku do të përfshihen dhe infrastruktura e nevojshme dhe ndërtesat e përpunimit. Si rrjedhim, kjo ndikim edhe në zhvillimin e popullsisë së Komunës së Prizrenit.

Do të ketë një ndikim në peizazh, pasi në zhvillimin e aktiviteteve prodhuese përfshihet edhe ndërtimi i ndërtesave dhe infrastrukturës së nevojshme për përpunimin e produkteve bujqësore primare.

Për sa i përket tokës, faktorëve klimaterik, biodiversitetit dhe trashëgimisë kulturore, nuk është e mundur të përcaktohet një ndikim i Prioritetit 8 për faktorët konkretë mjedisorë.

Prioriteti 9 ka lidhje me mbrojtjen , promovimin dhe reklamimin e gjithë monumenteve arkeologjike- kulturore të Komunës, lidhet me faktorët e mëposhtëm mjedisorë:

Lidhet me ajrin pasi synon rritjen e vizitueshmërisë së monumenteve dhe si pasojë, rritjen e lëvizjes së mjeteve të transportit publik dhe privat për/dhe nga monumentet. Mjetet e transportit konsumojnë energji dhe çlirojnë ndotës që shkarkohen në atmosferë.

Lidhet me zhurmën në mënyrë indirekte, pasi lëvizjet dhe përqëndrimet e turistëve shkaktojnë zhurmë.

Lidhet me peizazhin, pasi ndërhyrjet që propozohen janë, ndërmjet të tjerash, të ndjeshme (p.sh. rinovimi i objekteve me vlera kulturore dhe zonat përreth monumenteve).

Do të ketë ndikim në trashëgiminë kulturore, pasi Prioriteti 9 synon rritjen e trafikut në monumentet e kulturës dhe në vendet arkeologjike të rajonit për të cilat propozohen projekte rizhvillimi, ruajtjeje dhe përdorimi.

Do të ketë ndikim të Prioritetit 9 në popullsi dhe në asetet aktive, pasi do të ketë ndikim në biznesin profesional dhe në mundësitë e komunitetit lokal, përmirësimin e ekonomisë lokale, përmirësimin e nivelit të jetesës së popullsisë dhe si rrjedhim në përmirësimin e gjendjes së tyre financiare. Në një këndvështrim më të gjerë, do të ndikojë edhe në rritjen e popullsisë së Komunës.

Për sa i takon tokës, faktorëve klimatikë, ujërave, biodiversitetit dhe mbetjeve, nuk është e mundur të përcaktohet ndikimi i Prioritetit 9 në faktorët konkret mjedisorë.

Prioritetit 10 ka lidhje me forcimin, zhvillimin dhe shfrytëzimin e hapësirave kulturore dhe të veprimtarive të reja kulturore, lidhet me faktorët e mëposhtëm mjedisorë:



Komuna e Prizrenit
DUPH



Lidhet me ajrin pasi synon rritjen e vizitorëve në monumenteve dhe si pasojë, rritjen e lëvizjes së mjeteve të transportit publik dhe privat për/dhe nga monumentet. Mjetet e transportit konsumojnë energji dhe çlirojnë ndotës që shkarkohen në atmosferë.

Lidhet me zhurmën në mënyrë indirekte, pasi lëvizjet dhe përqëndrimet e turistëve shkaktojnë zhurmë.

Lidhet me peizazhin, pasi ndërhyrjet që propozohen janë, ndërmjet të tjerash, të ndjeshme (p.sh. rinovimi i objekteve me vlera kulturore dhe zonat përreth monumenteve).

Do të ketë ndikim në trashëgiminë kulturore, pasi Prioriteti 10 synon rritjen e trafikut në monumentet e kulturës dhe në vendet arkeologjike të rajonit për të cilat propozohen projekte rizhvillimi, ruajtjeje dhe përdorimi.

Do të ketë ndikim të Prioritetit 10 në popullsi dhe në asetet aktive, pasi do të ketë ndikim në biznesin profesional dhe në mundësitë e komunitetit lokal, përmirësimin e ekonomisë lokale, përmirësimin e nivelit të jetesës së popullsisë dhe si rrjedhim në përmirësimin e gjendjes së tyre financiare. Në një këndvështrim më të gjerë, do të ndikojë edhe në rritjen e popullsisë së Komunës së Prizrenit.

Për sa i takon tokës, faktorëve klimatikë, ujërave, biodiversitetit dhe mbetjeve, nuk është e mundur të përcaktohet ndikimi i Prioritetit 10 në faktorët konkret mjedisor.

Prioritetit 11 që ka lidhje me përmirësimin/modernizimin e rrjeteve të shërbimeve me interes të përbashkët (ujësjellës, kanalizime, energji, menaxhim të mbetjeve) në qytet dhe në vendbanime të tjera, dhe me përmirësimin e infrastrukturës teknike mjedisore, lidhet me faktorët e mjedisit si në vijim:

Lidhet me tokën, që përbën tregues marrësin e ujit të pijshëm – ujërave të zeza nga rrjedhjet në sistemet e furnizimit me ujë – kanalizimeve, si edhe është tregues i gjendjes së pakontrolluar të mbetjeve kur rrjetet e përfitimit të përbashkët nuk ekzistojnë apo funksionojnë keq.

Uji lidhet me Prioritetit 11, për sa i përket ekonomizimit të tij në rrjetet e furnizimit me ujë dhe mbrojtjes së burimeve ujore të cilat sot janë treguesë të ujërave të zeza të vendbanimeve.

Biodiverziteti mund të ndikohet nga ndërtimi i rrjeteve urbane të infrastrukturave, pasi një pjesë e tyre ndërtohen gjithmonë jashtë rrjetit urban.



Komuna e Prizrenit
DUPH



Mbetjet, të lëngëta dhe të ngurta, lidhen me Prioritetin 11, ndërsa menaxhimi i tyre arrihet vetëm nëpërmjet një sistemi të plotë reduktimi, parandalimi, riciklimi, kompostimi, groposjeje, për mbetjet e ngurta dhe përpunimit dhe gjendjes për mbetjet e lëngëta (ujërat e zeza të vendbanimeve).

Përmirësimi dhe modernizimi i rrjeteve urbane të interesit të përbashkët do të shkaktojë ndikime në cilësisinë e jetës së qytetarëve dhe zonat e banuara, ato do të jenë zona më tërheqëse urbane, kështu që do të ketë ndikim si në faktorin mjedisorë të popullsisë ashtu edhe në asetet aktive.

Përsa i përket ajrit, faktorëve klimaterikë, peisazhit, trashëgimisë kulturore dhe zhurmës, nuk është e mundur të përcaktohet ndikim i Prioritetit 11 në faktorët konkretë mjedisorë.

Prioritetit 12 që ka lidhje me përmirësimin e dhe modernizimin e infrastrukturës së transporteve, lidhet me faktorët mjedisorë si në vijim:

Lidhet me ajrin, pasi ndryshon të dhënat e qarkullimit p.sh. ngarkesat në qarkullim dhe në këtë mënyrë, ndikon në cilësinë dhe sasinë e ndotësve atmosferikë që emetohen nga automjetet.

Lidhet indirekt me faktorët klimaterikë si rezultat i korrelacionit të tyre me ajrin.

Lidhet me zhurmën, pasi kjo është drejtëpërdrejt e lidhur me sektorin e transporteve dhe kushtet e qarkullimit që mbizotërojnë dhe meqë Prioritetit propozon forma alternative lëvizjeje (p.sh. biçikleta) dhe ndërhyrje në akset rrugore, do të ketë ndikim edhe në mjedisin akustik.

Lidhet me popullsinë, pasi ndërhyrjet e mundshme do të kenë si qëllim përfundimtar lehtësimin e banorëve dhe përdorimin nga aspekti teknologjik të mjeteve të mëparshme të transportit që përbëjnë elementë pasurorë materialë për Komunën dhe për banorët e saj.

Lidhet me trashëgiminë kulturore, pasi ka të bëjë me lidhjen dhe aksesin ndër të tjera, edhe të monumenteve kulturore të Prizrenit.

Lidhet me peisazhin, ndërsa çdo ndërhyrje në rrjetin rrugor (ndërtimi i nyjave rrugore, i arterieve të reja rrugore, shndërrimi i rrugëve të fshatit në rrugë të asfaltuara, etj.) reflektohen në peisazh.

Përsa i përket tokës, ujit, biodiversitetit dhe mbetjeve, nuk është e mundur të përcaktohet ndikim i Prioritetit 12 në faktorët konkretë mjedisorë.

Aksi i Prioritetit 13 që ka lidhje me përmirësimin e infrastrukturës sociale, lidhet me faktorët mjedisorë si në vijim:



Komuna e Prizrenit
DUPH



Lidhet me popullsinë dhe elementët pasurorë materialë, pasi shërbimet e arsimit përmirësojnë nivelin e dijeve të qytetarëve dhe për pasojë, mundësitë profesionale të banorëve dhe sjelljen e tyre mjedisore, ndërsa kujdesen për rritjen e pritshmërisë së jetës së tyre. Në vazhdim, popullsia e Komunës bëhet akoma më shumë konkurruese nga aspekti ekonomik edhe më shumë aktive, dhe ka shanse rritjeje të nivelit të jetesës.

Përsa i përket tokës, ajrit, faktorëve klimaterikë, ujit, biodiversitetit, mbetjeve, zhurmës, trashëgimisë kulturore dhe peisazhit, nuk është e mundur të përcaktohet ndikim i Aksit të Prioritetit 13 në faktorët konkretë mjedisorë.

Prioritetit 14 që ka lidhje me mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit të strukturuar/ rezidencial, lidhet me faktorët mjedisorë si në vijim:

Lidhet me mbetjet pasi ato janë prodhuar brenda një mjedisi të banuar dhe rregullojnë degradimin ose përmirësimin një totali rezidencial.

Lidhet me zhurmat pasi në qytete ekzistojnë përdorime toke me funksione të tilla që gjenerojnë zhurma (si vendet e argëtimit, hapësirat prodhues, arteriet rrugore, shërbimet publike). Aksi Prioritar parashikon përmirësimin e zhurmës brenda qytetit.

Lidhet me popullsinë dhe me asetet e saj, pasi parashikon përmirësimin e kushteve të jetesës brenda në qytet dhe përmirësimin e ndërtesave domethënë të aseteve aktive të tyre.

Lidhet me Peisazhin dhe konkretisht me Peisazhin urban, me ndërhyrje estetike dhe të efijensës energjetike në ndërtesa dhe në zonat e gjelbra të qyteteve dhe të vendbanimeve.

Për sa i përket tokës, ajrit, faktorëve klimatikë, ujit, biodiversitetit dhe trashëgimisë kulturore nuk është e mundur për tu përcaktuar ndikimi i Prioritetit 14 tek faktorët specifik mjedisor.

Tabela e më poshtme tregon lidhjen midis prioritetëve të ndryshme të planit dhe parametrave Mjedisor:

Tabela 3. Tabela e Identifikimit të Ndikimeve Mjedisore për çdo Prioriteti dhe Faktori Mjedisor (√: Ndikimi i Prioritetit në faktorin mjedisor, X: nuk ka efekt të Prioritetit në faktorin mjedisor).

	To ka	Ajri	Faktorët klimatik e	Uji	Biodever siteti	Mbet jet	Zhu rma	Popullsia dhe asetet materiale	Trasheg imia Kulturo re	Peizazhi
Objektivi strategjik 1" Mbrojtja dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Mjedisit dhe Burimeve Natyrore "										
Prioriteti 1: Mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore	√	X	X	X	√	√	X	√	X	√
Prioriteti 2: Mbrojtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i ekosistemeve pyjore	√	√	√	X	√	X	X	√	X	√
Prioriteti 3: Mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujore	√	X	X	√	√	X	X	√	X	√
Prioriteti 4: Mbrojtje dhe përdorim i qëndrueshëm i tokës bujqësore	√	X	X	√	X	√	X	√	X	√
Prioriteti 5: Sensibilizimi mjedisor i komunitetit lokal	√	X	X	√	X	√	X	√	X	X
Objektivi strategjik 2" Rregullimi i infrastrukturës rrugore "										



Komuna e Prizrenit
DUPH



Prioriti 6: Zhvillimi turistik	√	√	X	√	X	√	√	√	√	√
Prioritari 7: Modernizimi dhe rritja e prodhimit primar	√	√	X	√	X	√	√	√	√	√
Prioritari 8: Përforcimi i prodhimit dytësor dhe tregtisë	X	√	X	√	X	√	√	√	X	√
Objektivi strategjik 2 " Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të Prizrenit "										
Prioritari 9: Mbrojtja, promovimi dhe reklamimi i të gjitha monumenteve arkeologjike-kulturore të komunës	X	√	X	X	X	X	√	√	√	√
Prioriteti 10: Përforcim, zhvillim dhe shfrytëzim i vendeve kulturore dhe aktiviteteve të reja kulturore	X	√	X	X	X	X	√	√	√	√
Objektivi strategjik 4: " Përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve "										
Prioriteti 11: Përmirësim/modernizim i rrjeteve të shërbimeve urbane në qytet dhe në vendbanimet e tjera, përmirësimi i infrastrukturës teknike mjedisore	√	X	X	√	√	√	X	√	X	X



Komuna e Prizrenit
DUPH



Prioriteti 12: Përmirësimi, modernizimi i infrastrukturës dhe sistemeve të transportit	X	√	√	X	X	X	√	√	√	√
Prioriteti 13: Përmirësimi i infrastrukturës sociale në të gjithë vendin sipas nevojës	X	X	X	X	X	X	X	√	X	X
Prioriteti 14: Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit të banimit/ndërtimet	X	X	X	X	X	√	√	√	X	√

Tabela 4. Tabela e Parashikimeve të Ndikimeve Mjedisore për çdo Prioriteti dhe Faktori Mjedisor, sipas deklaratës se mëparshme

	<i>Ndikimi i Prioritetit në faktorin mjedisor do të jetë shumë pozitiv.</i>
	<i>Ndikimi i Prioritetit në faktorin mjedisor do të jetë pak pozitiv.</i>
	<i>Ndikimi i Prioritetit në faktorin mjedisor do të jetë pak negativ.</i>
	<i>Ndikimi i Prioritetit në faktorin mjedisor do të jetë shumë negativ.</i>
	<i>Sipas Stadi të Identifikimit të Ndikimeve në Mjedis , Prioritetit nuk lidhet me faktorin mjedisor.</i>



Komuna e Prizrenit
DUPH



	Toka	Ajri	Faktorët klimatike	Uji	Biodeversiteti	Mbetjet	Zhurma	Popullsia dhe asetet materiale	Trashegi mia Kulturore	Peizazhi
Objektivi strategjik 1 " Mbrojtja dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Mjedisit dhe Burimeve Natyrore "										
Prioriteti 1: Mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore										
Prioriteti 2: Mbrojtja dhe përdorimi qëndrueshëm i ekosistemeve pyjore										
Prioriteti 3: Mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujore										
Prioriteti 4: Mbrojtje dhe përdorim i qëndrueshëm i tokës bujqësore										
Prioriteti 5: Sensibilizimi mjedisor i komunitetit lokal										
Objektivi strategjik 2" Rregullim i infrastrukturës rrugë "										
Prioriteti 6: Zhvillimi turizmit										
Prioriteti 7: Modernizimi dhe rritja e prodhimit primar										



Komuna e Prizrenit
DUPH



Prioriteti 8: Përforcimi i prodhimit dytësor dhe tregtisë										
Objektivi strategjik 3 " Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të Komunës "										
Prioriteti 9: Mbrojtja, promovimi dhe reklamimi i të gjitha monumenteve arkeologjike-kulturore të Komunës										
Prioriteti 10: Përforcim, zhvillim dhe shfrytëzim i vendeve kulturore dhe aktiviteteve të reja kulturore										
Objektivi strategjik 4: " Përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve "										
Prioriteti 11: Përmirësim/modernizim i rrjeteve të shërbimeve urbane në qytet dhe në vendbanimet e tjera, përmirësimi i infrastrukturës teknike mjedisore										
Prioriteti 12: Përmirësimi, modernizimi i infrastrukturës dhe sistemeve të transportit										
Prioriteti 13: Përmirësimi i infrastrukturës sociale në të gjithë										



Komuna e Prizrenit
DUPH



vendin sipas nevojës										
Prioriteti 14: Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit të banimit/ndërtimet										

7.2. Tajtimi i ndikimeve mjedisore të propozimeve të HZK të Komunës së Prizrenit

Është fakt, në përgjithësi i konstatuar, në komunitetin global shkencor se Studimet Strategjike të Ndikimit Mjedisor mund të sigurojnë kuadrin për hartimin e Vlerësimeve më të mira dhe më të sukseshme të Ndikimit Mjedisor në plane të ndryshme të propozuara në të ardhmen.

Njëkohësisht, ky Vlerësim Strategjik i Ndikimit Mjedisor të Hartës Zonale Komunale është e mundur të përbëjë një "mjet kontrolli" të Vlerësimeve të ardhshme të Ndikimit në Mjedis që do të përgatiten për projekte të ndryshme të propozuara, pasi komunitetet lokale dhe të gjitha palët e interesuara që do të marrin pjesë në procedurat e konsultimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, do të kenë mundësinë të përdorin këtë Vlerësim Strategjik Mjedisor të Hartës Zonale Komunale si një mjet ndihmë.

Tabela 5. Përmbledhje e ndikimeve mjedisore të parashikuara negative tek faktorët mjedisore dhe të masave të propozuara të trajtimit të tyre.

Faktorë mjedisorë	Ndikime të parashikueshme negative	Masa të propozuara të trajtimit
Toka	<p>Ndotje të tokës nga pesticidet dhe plehrat kimike në kuadër të fuqizimit të sektorit primar;</p> <p>Ndotja nga mihjet sipërfaqësore;</p> <p>Ndotja nga hudhja e pakontrolluar e mbeturinave</p>	<p>Mbështetje shkencore të fermerëve, krijimi i kooperativave bujqësore, adaptimi i praktikave dhe rregullave të drejta dhe nga Udhëzimet e Bashkimit Evropian;</p> <p>Inspektimet e rregulla Komunale;</p>
Ajri	<p>Ndotje e ajrit për arsye të zhvillimit të turizmit, me rritje të lëvizjes;</p> <p>Sektori ndërtimor i pakontrolluar;</p> <p>Rrugë të pashtuara;</p> <p>Rritja e shpejtë e numrit të automjeteve me karburan të cilësisë së keqe;</p> <p>Gjeneratorë me naftë;</p> <p>Sektori i amvisorisë ku përdorin për ngrohje thëngjin.</p>	<p>Zbatim i projektit të qëndrueshëm të lëvizshmërisë duke nxitur lëvizjen më këmbë, përdorimin e biçikletave dhe transportin publik, mbrojtjen e ekosistemeve pyjore;</p> <p>Rritja e inspektimeve mjedisore;</p> <p>Përdorimi i energjisë alternative në vend të nxemjes së thëngjill</p>



Komuna e Prizrenit
DUPH



<p>Ujëra</p>	<p>Derdhja e pakontrolluar e ujërat e ndotura në lumej;</p> <p>Ndotje dhe ndikim në sasinë e ujërave nëntokësore nga intensifikimi dhe forcimi i prodhimit primar;</p> <p>Përdorim i ujit për promovimin e përpunimit të produkteve bujqësore dhe në përgjithësi të sektorit dytësor të prodhimit</p> <p>Përdorim të ujit nga zhvillimi dhe promovimi i turizmit dhe i agroturizmit</p>	<p>Trajtimi i ujërave të ndotura me ndërtimin e impiantit të trajtimit të ujërave të zeza, reduktimi i përdorimit gropave septike dhe lidhja me sistemin e kanalizimeve për ujërat e ndotura,</p> <p>Zbatim i një plani të qëndrueshëm të menaxhimit të ujit për ujitje - mbështetje shkencore të fermerëve - ndërtim i rrjeteve moderne kolektive të ujitjes - ndërtim të rezervuareve dhe digave - kontrolli i shpimeve të shpërndara të fermerëve</p> <p>Zgjerimi i politikës së përshtatshme të faturimit për ujin - organizim hapësinor dhe përqendrim i njësive prodhuese në rajonet ekonomike me qëllim menaxhimin kolektiv të ujit - kontroll i njësive individuale të shpimeve për ujë - përdorim të makinerive bashkëkohore tek njëistë prodhuese - adaptim nga njësitë prodhuese të Sistemeve të Menaxhimit Mjedisor</p> <p>Reduktim të konsumit të ujit për ujitje, përmes zbatimit të sistemeve të kursimit</p> <p>– përmes informimit dhe ndërgjegjësimit të vizitorëve</p>
---------------------	---	--



Komuna e Prizrenit
DUPH



<p>Biodiversiteti</p>	<p>Ndërtim dhe operim i infrastrukturës energjetike, vend depozitimit, impiantit të trajtimit të ujërave të zeza;</p> <p>Rritja e disa vendbanimeve por edhe zhvillimit me karakter ndërtimi po shkaktojnë humbje në pyje dhe habitat;</p> <p>Rritje e ndotjes</p>	<p>Trajtim parandalues me vendosje të përshtatshme të rrjeteve dhe të infrastrukturave teknike dhe mjedisore;</p> <p>Nevoja për të pasur një studim bazë për Komunën e Prizrenit me qëllim identifikimin e humbjeve në biodiversitet dhe mundësitë për përmirësimin e situatës;</p> <p>Ndërmarrja e masave për përmirësimin e gjendjes aktuale të ndotjes mjedisore.</p>
<p>Faktorë mjedisorë</p>	<p>Ndikime të parashikueshme negative</p>	<p>Masa të propozuara të trajtimit</p>
<p>Mbetje</p>	<p>Grumbullimi i mbetjeve në komunë nuk është plotësisht i rregulluar pasi shumë prej tyre hidhen në lumenj dhe zona të tjera;</p> <p>Mungesa e sistemit të klasifikimit të mbetjeve; Mbetjet ndërtimore, dhe ato të tjera përzihen me mbetjet komunale;</p>	<p>Grumbullim më i mirë në vendbanime dhe nivel komunal;</p> <p>Vënie në jetë e strategjive për reduktimin e mbetjeve dhe për riciklimin;</p> <p>Ndarje më e mirë e materialeve të rrezikshme për mesazhin e klasifikimit të mbetjeve;</p> <p>Për të shmangur hedhjet e paligjshme, organizimi mund të bëhet</p>



Komuna e Prizrenit
DUPH



	<p>Shtim i mbetjeve nga aktivitetet e sektorit të prodhimit dytësor;</p> <p>Shtim të mbetjeve nga aktivitetet e turizmit dhe agroturizmit</p>	<p>nga komuna për një numër të mjaftueshëm kamionësh, dhe të menaxhohet me transport nga deponia e përkohëshme drejt asaj regjionale njëjtë të menaxhohet me pagesë për tone për hedhjen e mbeturinave në Deponin e regjionale duke krijuar sistem pagesash nga ata që hudhin mbeturina;</p> <p>Promovim i riciklimit të materialeve të ndryshme - promovim i bio-kompostimit dhe mbetjeve të " gjelbërta" - informim të banorëve në lidhje me çështjet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta;</p> <p>Informim dhe ndërgjegjësim i vizitorëve për menaxhimin e mbetjeve dhe ndarja e tyre për përpunimin e tyre optimal dhe shfrytëzimin e tyre.</p>
--	---	--



Komuna e Prizrenit
DUPH



Mjedisi akustik/zhurma	<p>Qarkullimi i dendur dhe kaotik rrugor vlen të ceket me theks rrugët regjional e mosrespektimi i rregullav e të qarkullim it rrugor;</p> <p>Numri i lartë i automjete ve private për shkak të moseficensës së transportit publik;</p> <p>Ushtrimi i aktiviteteve argëtuese jashtë standarteve, cilësia e ulët karburanteve të automjeteve,</p> <p>Zhurme nga zhvillimi i turizmit</p>	<p>Përmirësim i lvizshmërisë nga dhe në drejtim të hapësirave turistike, përmirësim të rrjeteve urbane të transportit dhe përdorim të mjeteve alternative të transportit;</p> <p>Izolimi akustik i ndërtesave - organizim hapësinor i njësive të përpunimit në zona ekonomike</p>
Peizazhi	Ndryshime në peizazh nga aktivitetet e përpunimit të produkteve bujqësore	Organizim hapësinor i njësive të përpunimit në zonat ekonomike – zona perimetrike të gjelbërta në çdo zonë ekonomike

8. MONITORIMI

Ky Vlerësim Strategjik i Ndikimeve Mjedisore i Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit identifikoi, parashikoi dhe vlerësoi ndikimet mjedisore të propozimeve të planin që po përgatitet (HZK), propozoi masa për trajtimin e ndikimeve mjedisore dhe të formuloi një program për monitorimin e tyre, në mënyrë që të verifikohet se Plani në të ardhmen zbatohet në drejtimin e duhur dhe se masat e trajtimit, nëse janë të nevojshme, zbatohen, në mënyrë që të mos ekzistojnë shqetësime dhe ndikime negative në mjedis.

Siç rezultoi qartë nga analiza e mësipërme, efektet negative janë të kufizuara në faktorë të veçantë të mjedisit (në toka, ajër, ujë, biodiversitet, mbetje, mjedisi akustik/zhurma dhe peizazh), ndërsa efektet pozitive të Planit të propozuar janë më të rëndësishme dhe kanë të bëjnë me të gjithë faktorët e mjedisit. Kjo është e drejtë dhe e pritshme, pasi që nga fillimi i hartimit të propozimeve.

Plani ka marrë parasysh kriteret e zhvillimit të qëndrueshëm, duke integruar në kohë dimensionin mjedisor dhe parametrin e mbrojtjes dhe përmirësimit të mjedisit natyror, kulturor dhe njerëzor në çdo objektiv strategjik dhe në çdo Prioritet. Kështu, që nga fillimi Plani kishte orientim miqësor me mjedisin dhe për këtë arsye, nuk është për t'u habitur që në vlerësimin e ndikimeve mjedisore, shumë ndikime janë pozitive dhe sa prej tyre janë negative, shpesh varet nga mënyra e zbatimit të Planit.

Së fundi, paraqitet programi i monitorimit të ndikimeve në mjedis, në të cilin përcaktohen treguesit e monitorimit, nevoja e përpilimit të raportit të përfunduar me rezultatet dhe organin përgjegjës për zbatimin e programit të monitorimit.

Në dobi të arritjes së objektivave të parapara në Hartën Zonale Komunale të Prizrenit, aktivitetet për monitorim, koha e monitorimit, si dhe institucioni përgjegjës janë paraparë në tabelën në vijim:



Tabela 6. Plani i monitorimit

Aktiviteti	Periudha e monitorimit	Përgjegjës
Implementimi i standardeve dhe objektivave të parapara në këtë plan me rastin e ndërtimeve	Gjatë fazës së ndërtimit	Inspektorati i komunës Drejtoria për Urbanizëm Planifikim dhe Mjedis
Implementimi masave të paraparë me këtë plan, si dhe i projekteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) me rastin e planifikimit dhe ndërtimit të infrastrukturës rrugore	Gjatë fazës së planifikimit dhe ndërtimit	Drejtoria për Urbanizëm Planifikim dhe Mjedis Inspektorati i Komunës Inspektorati i MMPH
Planifikimi dhe installimi i infrastrukturës së shërbimeve publike	Gjatë fazës së ndërtimit Mirëmbajtja në mënyrë të vazhdueshme	Drejtoria e Shërbimeve publike. Kompania rajonale e ujësjellësit
Menaxhimi i mbeturinave	Në mënyrë të vazhdueshme	Kompania për menaxhimin e mbeturinave Drejtoria e Shërbimeve Publike Inspektorati komunal
Shkarkimi i ujërave të zeza	Në mënyrë të vazhdueshme	Kompania rajonale e ujësjellësit Drejtoria e Shërbimeve publike Inspektorati
Ciëlsia e ajrit	Vlerësime të	Agjencia për Mbrotjen



Komuna e Prizrenit
DUPH



	<i>kohëpaskohëshme</i>	<i>e Mjedisit të Kosovës (AKMM); Drejtoria e Shërbimeve publike</i>
--	------------------------	---



9. LITERATURA

1. Harta Zonale e Komunws sw Prizrenit, Maj 2019
2. Plani Zhvillimor i Komunës së Prizrenit, 2013-2025
3. Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, Strategjia për Mjedisin 2013-2022). Prishtinë, 2013.
4. Gjendja e Mjedisit në Kosovë 2008-2010;
5. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin; 2011 – 2020;
6. Ligji i Kosovës për Planifikim Hapësinor. [dokumenti WWW] URL: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2003_14_en.pdf
7. Ligji Kosovës për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit. [dokumenti WWW] URL: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-230-eng.pdf>
8. Plani Lokal i Veprimit Lokal në Mjedis 2012 – 2017.
9. Plani Lokal i Menaxhimit të Mbeturinave 2016-2021.
10. Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve (2009).
11. Raport I Hospoteve Mjedisore nw Kosove, 2012
12. Ernest A. Lowe (1997-2001) Eco-industrial Park Handbook for Asian Developing Countries.
13. Agjensia Kosovare e Mbrojtjes së Mjedisit. Raport i Gjendjes së Monitorimit të Mjedisit per vitin 2010. A
14. Profili Komunal i Prizrenit, 2007
15. Agjenda 21, UN-Habitat (2009). Planning for Sustainable Cities, UN-Habitat. Nairobi, Kenya.
16. Millennium Development Goals Global Targets-Local Approaches;



17. Qendra Rajonale e Mjedisit. REC.
18. London, ODPM Publications, 2005.
19. PARTIDÁRIO, Maria do Rosário, Guia de Boas Práticas para Avaliação Ambiental Estratégica: Orientações Metodológicas, Lisbon, Agência Portuguesa do Ambiente, 2007.
20. UN-HABITAT, State of the World's Cities: Cities for All, bridging the urban divide, London, Earthscan, 2010.
21. World Business Council for Sustainable Development, Cement Technology roadmap: carbon emission reductions up to 2050, Paris, International Energy Agency, 2009.
22. European Parliament/Council Habitats Directive, 1992. [WWW document] URL: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:31992L0043:EN:NO>
23. Arce, R. and Gullón, N. (2000), "The application of Strategic Environmental Assessment to sustainable assessment of infrastructure development", Environmental Impact Assessment Review, 20, pp.393-402.
24. Blowers, A. (1992), "Sustainable Urban Development: the Political Prospects", in Breheny, M.J.
25. (Ed.), Sustainable Development and Urban Form, London: Pion Limited, pp. 24-38.
26. Breheny, M. (1992), "The Contradictions of the Compact City: A Review", in Breheny, M.J. (Ed.),
27. Sustainable Development and Urban Form, London: Pion Limited, pp. 138-157.
28. Breheny, M. and Rookwood, R. (1996), "Planning the Sustainable City Region", in Blowers, A. (ed.), Planning for a sustainable environment, London: Earthscan Publications Ltd, pp. 150-189.
29. Breheny, M. (1997), "Urban compaction: feasible and acceptable?", Cities, 14 (4), pp. 209-217.
30. Dalal-Clayton, B. and Sadler, B. (1999), Strategic Environmental Assessment: A Rapidly Evolving Approach, London: International Institute for Environment and Development.
31. Dalal-Clayton, B. and Sadler, B. (2003), The Status and Potential of Strategic Environmental Assessment, London: International Institute for Environment and Development.



32. Davidson, F. (1996), “Planning for Performance: Requirements for Sustainable Development”,
33. Habitat International, 20 (3), pp. 445-462.
34. Desmond, M. (2007), “Identification and development of waste management alternatives for Strategic Environmental Assessment (SEA)”, *Environmental Impact Assessment Review*, 29, pp.51– 59.
35. Fischer, T.B. (2002a), “Strategic Environmental Assessment Performance Criteria – The Same Requirements for Every Assessment?”, *Journal of Environmental Assessment Policy and Management*, 4 (1), pp.83-99.
36. Fischer, T.B. (2002b), *Strategic Environmental Assessment in Transport and Land Use Planning*, London: Earthscan Publications Ltd.
37. Fischer, T.B. (2003), “Strategic environmental assessment in post-modern times”, *Environmental Impact Assessment Review*, 23, pp.155-170.
38. Glasson, J., Therivel, R. and Chadwick, A. (2012), *Introduction to Environmental Impact Assessment*, London: Routledge, 4^η έκδοση.
39. Hautekeur, G. (2005), “Community development in Europe”, *Community Development Journal*, 40 (4), pp. 385-398.
40. Lahiri-Dutt, K. (2004), “‘I plan, you participate’: A southern view of community participation in urban Australia”, *Community Development Journal*, 39 (1), pp. 13-27.
41. Macedo, J. (2004), “City profile Curitiba”, *Cities*, 21 (6), pp. 537-549.
42. Mega, V. (2000), “Cities inventing the civilization of sustainability: an odyssey in the urban archipelago of the European Union”, *Cities*, **17** (3), pp. 227-236.
43. Morrison-Saunders, A. & Arts, J. (2004), *Assessing Impact – handbook of EIA and SEA Follow-up*, London: Earthscan Publications Ltd.
44. Noble, B.F. (2003), “Auditing Strategic Environmental Assessment Practice in Canada”, *Journal of Environmental Assessment Policy and Management*, **5** (2), pp.127-147.
45. Noble, B.F. (2010), *Introduction to Environmental Impact Assessment – A guide to Principles and Practice*, Oxford: Oxford University Press.



Komuna e Prizrenit
DUPH



-
46. Risse, N., Crowley, M., Vincke, Ph., Waaub, J.-Ph. (2003), “Implementing the European SEA Directive: the Member States’ margin of discretion”, *Environmental Impact Assessment Review*, **23**, pp. 453–470.
47. Roberts, I. (2000), “Lester environment city: learning how to make Local Agenda 21”, *partnerships and participation deliver Environment & Urbanization*, **12** (2), pp. 9-26.